

TOMAS MAN



S. APT



TOMAS MAN

Solomon Apt

Perktheu nga origjinali
Rexhina Alimerko

Përmbajta

BABAI	5
FËMIJËRIA, ADOLESHENCA...	16
...DHE RINIA	26
ITALIA	43
BASHKËPUNËTOR REDAKSIE	78
DIMËR I VËSHIRË	98
SUKSESI	111
KOMENTE LETRASH	120
PAS AFIRMIMIT	134
VËLLAI	157
NË MOSMARRËVESHJE ME VETEN DHE ME BOTËN	168
PËR PROFESOR KORNELIUSIN, REPUBLIKËN GJERMANE DHE UDHËTIMIN NË PARIS	201
DAFINAT DHE GJEMBAT	245
EMIGRANTI	275
RRËFIMI VAZHDON	302
BOTA E RE	325
PËRSËRI EUROPA	360
Dy fjalë për jetën dhe veprën e autorit Solomon Konstantinoviç Apt	379

BABAI

“Ne gjermanët i trembemi vetëm zotit, asgjëje tjetër në botë nuk i trembemi”. Mbasi i lexoi me zë të lartë këto fjalë nga një fjalim i radhës i Bismarkut, senatori Tomas Johan Hajnrih Man psherëtiu mbi gazetë dhe tha me zë të ulët:

- Në fakt iu trembemi shumë gjërave.

Këto fjalë i tha shkarazi, me një simpati mallëngjyese për kancelarin dhe deklaratën e tij të guximshme. Por në komentin e senatorit veshi i mprehtë i të birit kapi një dhembje të fshehur.

Në vitin 1888, kur Bismarku shqiptoi këtë frazë krenare në Rajhshtag, babai i dy shkrimtarëve të mëdhenj të ardhshëm nuk ishte as pesëdhjetë vjeç dhe, në shikimin e parë, pozita në Lybek, në vendlindjen e tij, nuk kishte përse t’i shkaktonte shqetësime dhe merak. Prej çerek shekulli trashëgonte nga gjyshi dhe i ati firmën “Johan Zigmund Man. Tregti drithi, operacione komisionimi dhe dërgesash”. Në Lybek ishte konsull dhe përfaqësonte interesat e Mbretërisë së Holandës. Përveç shtëpisë së prindërve, ku pleqëronte e ëma, ai kishte edhe një shtëpi të mrekullueshme të ndërtuar sipas shijes së vet për gruan dhe fëmijët, dhe, me sa duket, gazeta me fjalimin e kancelarit duhet të jetë lexuar me zë në ndonjërin nga dhomat e rehatshme të asaj shtëpie. Ai ishte jo vetëm afarist i njohur dhe baba i nderuar i familjes, por edhe një ndër banorët më të njohur e më të nderuar të qytetit, një ndër ata, të cilët quhen baballarët e qytetit.

Hanzë quhet bashkimi i tregtarëve i themeluar qysh në mesjetë nga tregtarët e vendeve baltike. Fjala e vjetër gjermane “hanza” ka kuptimin “bashkim”, “shoqëri”, “gildë”. Qysh në kohët e lashta qytetet hanzeatike, ndër të cilët Lybeku mbahej si kryesori pothuajse prej fundit të shekullit XIII, kanë qenë shtete të vogla të mëvetësishme. Kurse tani Lybeku bënte pjesë në Perandorinë Gjermane dhe, për shembull, garnizoni lokal varej nga korparmata e nëntë prusiane, por, megjithatë, në organizimin e qytetit të lashtë vazhdonin të ruheshin mbeturinat e sovranitetit hanzeatik. Në Lybek pushteti suprem i përkiste senatit, para të cilit qyteti dhe byrgerët¹

bënin betimin. Senati emëronte gjykatësit dhe nëpunësit e shtetit, kishte të drejtën e faljes së kriminelëve, kontrollonte arkën e qytetit. Senatori me ndikimin më të madh ishte ai që administronte taksat. Ato i administronte pikërisht senatori Tomas Johan Hajnrih Man.

Ky ishte i zhytur në punë deri në grykë. Shkruante letra pune për në Londër, Amsterdam, Peterburg, Kopenhagen, lidhte kontrata me pronarë anijesh dhe tregtarë, kujdesej për zbrazjen dhe mbushjen e hambarëve, emrat e të cilëve-“Luani”, “Balena”, “Shqiponja”, “Lisi” – edhe nëse nuk e ngacmonin përfytyrimin e këtij hanzeatiku brez pas brezi të mësuar me këtë simbolikë, ashtu siç ngacmojnë përfytyrimin tonë sot, sidoqoftë, ndoshta bënin që veshi i tij të ndjente frymën e traditës, të mënyrës së vjetër të jetesës, duke i kujtuar pareshtur pronarit të këtyre depove të drithit lidhjet e ngushta me profesionin e të parëve të tij. Ai merrte pjesë në senat dhe mbante fjalime, shkonte mysafir dhe priste mysafirë – ajkën e byrgerisë¹ së Lybekut, oficerë, tregtarë nga qytete të tjera. Kurse vizitorët, të cilët për ndonjë arsye zoti konsull nuk mundte t’i priste, linin kartëvizitat e tyre në një peshtaf të vendosur ndër putrat e mëdha të një ariu siberian të balsamosur – dhuratë me rastin e martesës, i cili qëndronte mbi një bazament të zi në paradhomën e shtëpisë së mrekullueshme...

Por shpirtërisht nuk ishte i qetë, ecuria e tregtisë e kënaqte gjithmonë e më pak, kurse e ardhmja e firmës e shqetësonte çdo vit e më shumë. Në vitin 1890 firma “Johan Zigmund Man” mbushi njëqind vjet. Jubileun e saj e festoi gjithë Lybeku. Qyteti dhe porti u stolisën me flamuj që valviteshin mbi çatitë e mprehta të shtëpive dhe në majat e direkëve të anijeve.

Në këtë ditë senatori Man mishëronte plot një shekull praktikiteti dhe korrektësie byrgere. Njerëzit vinin papushim për ta uruar në shtëpinë e tij me familje, vetëm, me përfaqësi, më këmbë, me karroca. Si njeri elegant e i shkathët që ishte, i mësuar të përfaqësonte e të kryesonte, kthente përshëndetjet, falënderonte,

¹ Nga gjerm. Bürger – qytetar, banor i qytetit. 2. Qytetaria (nga Bürgertum) – status social i banorëve të qyteteve në Gjermaninë mesjetare.

bënte shaka, por ky hero i ditës nuk ndiente gëzim të vërtetë, atë që me siguri në një festë të tillë do të kishin ndjerë gjyshërit dhe stërgjyshërit e tij.

Është gjë e këndshme të festosh një jubile kur i qëndron besnik frymës së të parëve dhe shikon i sigurtë drejt së ardhmes. Kurse senatori nuk i kishte as këtë besnikëri, as këtë siguri. Si djali më i madh që ishte, ruante nën kapakun e biblës së familjes një fletore të zverdhur nga koha, në të cilën stërgjyshi dhe babai i tij kishin regjistruar ngjarjet më të rëndësishme në historinë e familjes si kujtim për pasardhësit. Stërgjyshi kishte filluar nga datëlindja e gjyshit të vet, nga viti 1644. Pastaj vinin shënime për martesat, pagëzimet, vdekjet, për daljen e dhëmbëve të fëmijëve, për sëmundjet që kishin kaluar fëmijët dhe të rriturit, për farefisin dhe krushqitë e reja, për gjurmët më të thella të jetës. Babai i senatorit i kishte rishkruar shënimet e gjyshit të vet sipas drejtshkrimit të ri dhe i kishte plotësuar me të dhëna për veten dhe fëmijët e vet. Vërtet boja e shkrimit që kishte përdorur babai ishte zbardhlytur prej kohësh, por ama këto fletore ishin të mbushura plot me forcë, plot me devotshmëri fetare, plot me bindje se po jetohej një jetë e rregullt dhe po bëhej një punë e dobishme. Ja çfarë shkruante gjyshi: “Në vitin 1744 shkova në Bergen, atje m'u desh të punoja shumë, në fillim e pata tepër të vështirë, por shpejt u mësova, sepse I Gjithëfuqishmi më ka dhuruar një trup shumë të shëndoshë, prandaj punoja me dëshirë, edhe kur të tjerët ankoheshin se nuk e përballonin dot, unë një gjë të tillë pothuajse kurrë nuk e mendoja, isha i kënaqur me gjithçka, edhe me të ëmblat edhe me të hidhurat: sepse i isha betuar babait se do të shërbeja me nder dhe nuk do të dukesh në qytetin e tij para se të mbusheshin dhjetë vjet. Unë, sigurisht, mund të rrëfeja shumë gjëra, sikur të isha i prirur të flisja për hallet që kam kaluar, por nuk më pëlqen, sepse synimi im është të ndihmoj pasardhësit të njohin lavdinë e zotit”. Ose: ”Në vitin 1782, në datën 5 të muajit prill, në orën 7 të mëngjesit u lind bija ime Dorotea Kristina Katarina, më 16 të po atij muaji e pagëzoi prifti zoti doktor Deterding. Nunët ishin: zonja vjehërr-senatoresha zonja Bylov, e shoqja e kryetarit të bashkisë zonja Nojkrantcen, zonja

kunatë-vejusha zonja Man. Zoti e rritë për lavdinë e tij, i dhëntë mend dhe arsye, e drejtoftë në rrugën e virtytit...Amin! Le të thërrasim (në origjinal vazhdon në vargje- S.A.):”Gëzim, gëzim dhe përsëri gëzim! Krishti do të largojë të gjitha dhembjet. Lumturi, lumturi dhe përsëri lumturi! Ai është dielli ynë mëshirëplotë”.

Edhe për gjyshin e senatorit, pikërisht për atë Johan Zigmund, emrin e të cilit mbante firma njëqindvjeçare, shkrimet e familjes jepnin disa hollësi që tregonin se sa energjik ishte gjyshi, sa shumë interes djaloshar kishte për botën, atë interes, i cili ngjallet te njeriu që ka shpresën dhe ndjesinë se po fillon një vepër të madhe, dhe humbet te njeriu i zhgënjyer dhe i lodhur. Në arkivin e senatorit gjendej, ndër të tjera, edhe një dorëshkrim me një titull të gjatë që dëshmonte se atmosfera e kureshtjes së gjallë për jetën e rrethonte gjyshin edhe në pleqërinë e thellë, - “Një përshkrim interesant i udhëtimit të Johan Zigmund Man-plakut dhe Kristian Brokmanit nga Hamburgu në Angli dhe Brabant më 12 korrik-12 gusht 1836”. Përshkrimin e ka bërë Brokmani, bashkudhëtari i Johan Zigmundit, i cili në vitin e udhëtimit ishte as më shumë e as më pak por plot shtatëdhjetë e pesë vjeç. Siç del nga “Përshkrimi”, tregtarët gjermanë e kanë vizituar Londrën me entuziazëm adoleshentësh. Kanë vizituar kopshtin zoologjik, ku kanë parë “një rinoceront, dy gjirafa, dy elefantë, njëri prej të cilëve ishte shumë i madh, ujë dhe qenër të çdo race, tigra dhe zogj gjithfarësh”. Kanë vizituar doket, kantinën e verës. “Në kantinë provuam verëra të shkëlqyera “Porto”, verën “Sherry” me 70 funte² dhe “Paksarato”, e cila është e mrekullueshme dhe kushton 150 funte, që të dyja janë verëra spanjolle. Prej kësaj shkuam te tuneli nën Tamiz, i cili pas rifillimit të punimeve ka përparuar 140 këmbë dhe tani ka përfunduar në 5/8 e gjatësisë: dheun e gërmon një makinë me avull. Ndriçimi bëhet me gaz. Hyrja kushton 1 shilingë për person”. Në të njëjtën mënyrë janë përshkruar edhe gjëra të tjera tërheqëse të kryeqytetit anglez: dogana, tregu i peshkut “Billingsgeit”, banka. Banka e Londrës u ka ngjallur udhëtarëve-tregtarë një admirim profesional: “Na treguan

²Siç duket nga shifrat, tregtari ka parasysh çmimet me shumicë.

libra, ku gjithçka mund të gjendej shpejt dhe lehtë, gjithçka sipas rendit alfabetik nga A-ja te Z-ja, ja kështu: BA, BB, BC, BD. Cilido që shet një kartëmonedhë, një kambial ose një faturë banke duhet të shkruajë vetë shumën dhe të firmosë në një formular të shtypur paraprakisht, në të cilin thuhet: “Këtë dokument ia dorëzoj zotit NN””. Edhe në shënimet për Brygun, Antverpenin, Lytihun (Ljezhin), që Johan Zigmund-plaku dhe bashkudhëtari i tij i kanë vizituar gjatë kthimit për në Gjermani, ndjehet i njëjti qëndrim i hapur, kureshtar dhe optimist ndaj botës.

Çfarë e mundonte senatorin, çfarë e krijonte kufirin e padukshëm që i ndante këta njerëz energjikë e plot shpresë te e ardhmja, nga ai, pasardhësi i tyre? Natyrisht, ishin të tjera kohë, jo ato para njëqind, apo edhe para pesëdhjetë vjetësh. Dhe Lybeku nuk luante më atë rol të dorës së parë në tregtinë detare, me të cilin qyteti ishte mësuar prej shekujsh dhe i cili i bënte krenarë patricët e tij për pozitën shoqërore që zinin. Në vitin 1878 qeveria e Bismarkut vendosi tarifa të larta doganore, të cilat çuan në pakësimin e dukshëm të importit të drithit të lirë rus, i cili përbënte mallin më të rëndësishëm për tregtarët grosistë të Lybekut. Veç kësaj, në fund të shekullit XIX Lybeku e kishte të vështirë t’ia arrinte edhe rivalit të vet lindor, Shtetinit, i cili ishte bërë porta detare e Berlinit industrial, edhe Kilit, i cili pas hapjes së kanalit lundruës sikur ishte afruar me Detin e Veriut, dhe aq më tepër Hamburgut, i cili ishte bërë një port me rëndësi botërore. Por nuk ishte puna thjesht te ndryshimet mbarëgjermane. Krenaria për pozitën shoqërore është diçka që nuk humbet lehtë, ajo nuk nxiton të gjunjëzohet, të marrë parasysht rrethanat historike të pavolitshme për të, të heqë dorë nga vetvetja, të bindet para argumenteve të arsyes, sa kohë që këto argumente mbeten teorike. Disa patricë lybekas, miq të mirë të senatorit Man, vazhdonin të merreshin me tregti, të ndërtonin, të shkonin në kishë me zellin e stërgjyshërve, edhe pse kohët e reja e kishin zhytur qytetin në një plogështi provinciale të pashmangshme. Por edhe vetë senatori i lexonte me ëndje fjalimet e Bismarkut. Të mbushura plot shifra të sakta dhe patos kombëtar, ato ia ngrohnin zemrën birit të tregtarëve gjermanë, megjithëse, në thelb, politika centraliste e

rajhsgrinderit (themeluesit të perandorisë), i cili ua kishte hequr privilegjet esnafëve dhe shoqërive tregtare qysh në vitin 1866, nuk premtonte ndonjë kthesë vendimtare për firmën e vogël të Lybekut që edhe kështu nuk po lulëzonte.

Por kishte disa shkaqe më të afërta dhe të drejtpërdrejta, si pasojë e të cilave senatori Man e kishte humbur besimin te e ardhmja dhe kënaqësinë nga veprimtaria e vet e larmishme. Tendencat e përgjithshme të epokës që shënonte fundin e patriarkalizmit byrger u shfaqën te senatori me tërë mprehtësinë e rastit të veçantë, të fatit personal, për arsye të rrethanave të tij të veçanta familiare dhe të tipareve të tij të veçanta – të pedantizmit, të zellit, të sedrës së madhe.

Familjet e vjetra tregtare kanë pasur gjithmonë lidhje të forta farefisnore. Me martesën e djalit, si rregull, pjesa e tij në kapitalin e babait shtohet nga paja e gruas dhe nga mbështetja tregtare e vjehrrit, kurse martesës së vajzës së tregtarit zakonisht i paraprinte njohja e babait ose e vëllezërve të saj me librat e të ardhurave dhe shpenzimeve të dhëndrrit. As motra e madhe e senatorit Man, Elisabet Amalia Ipolita, as vëllai i tij i vogël Fridrih Vilhelm Lebreht, nuk iu bënë mbështetje. Motra u martua dy herë, dhe të dyja herët pa fat. Burri i parë, një tregtar i madh hamburgas, e mori pëlqimin për martesë kur ndodhej në prag të falimentimit, duke e mashtruar vjehrrin e ardhshëm me libra llogarie të falsifikuar. Nuk kaloi as një vit dhe mashtrimi u zbulua, por tetëdhjetëmijë markat e pajës së motrës përfunduan në xhepin e shpuar të batakçiut. Në martesën e dytë ajo nuk pati pajë, edhe kjo martesë rasti e shkurtër dhe kujdesi për motrën ra përgjithmonë mbi shpatullat e senatorit. Te burri tjetër i familjes, te vëllai i tyre i vogël, nuk mund të mbështeteshin. Duke qenë njeri mendjelehtë e i dhënë pas dëfrimeve, ai nuk përzihej në punët e firmës, nuk merakosej për ruajtjen e dinjitetit patrician -as të vetvetes, as të të afërmeve- por e prishte pjesën e trashëgimisë për qejf të vet dhe në dëm të kapitalit të Manëve.

As te fëmijët e vet senatori nuk shpresonte se do të ishin vazhdues të veprimtarisë tregtare të të parëve. Ai kishte pesë fëmijë,

tre djem dhe dy vajza. Kur flitej për pasardhësit, natyrisht, mbaheshin parasysh vetëm meshkujt. Por i vogli, Viktori, ishte ende foshnjë, ishte lindur në vitin e pesëdhjetëvjetorit të senatorit dhe njëqindvjetorit të firmës, ndaj ky nuk besonte se do të jetonte derisa djali të bëhej burrë. Sa për djalin e madh, Hajnrihun, ishte e qartë se ai nuk kishte ndërmend të merrej me tregtinë e drithit. Qysh herët kishte shfaqur prirje për letërsinë. Senatori nuk ishte aspak një njeri mediokër, që të mos i kuptonte pasionet humanitare. Vetë atij i pëlqente të dëgjonte kur bashkëshortja, nëna e fëmijëve të tij, luante në pianon “Behshtajn”, në sallonin me një qoshk plot dritë të shtëpisë që ai e kishte ndërtuar vetë, kurse gjatë pushimeve, në bregdetin e Travemyndes, i strukur në një kolltuk të thurur në formë tende, lexonte romanet e Zolasë fshehtas, sepse, gjithsesi, ai ishte shkrimtar me mendime të lira. Megjithatë, senatori e kishte të vështirë të pajtohej me mendimin se i biri, trashëgimtari i natyrshëm i firmës njëqindvjeçare, kishte vendosur ta ndërtonte jetën e vet mbi një themel kaq të dyshimtë, siç ishte veprimtaria letrare. Në të vërtetë, Hajnrihu nuk i ngjante xhaxhit mendjelehtë, fillimisht ai u muar me njëfarë pune konkrete, e cila përputhej me qëllimet e tij kalimtare më tepër sesa shitja e drithit, u muar me një punë të nderuar, ndonëse jo të traditës së Manëve. Në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare, në vitin 1889, ende pa mbaruar gjimnazin, ai iku nga Lybeku në Drezden, ku hyri si nxënës në firmën e një librashitësi. Tashmë senatori e kishte të qartë se djali i madh ishte shkëputur nga familja. Koha vërtetoi se senatori nuk ishte gabuar. Sepse Hajnrihu, për shembull, u kthye në qytetin e lindjes vetëm një herë gjatë gjithë jetës, madje për një kohë të shkurtër- sa për varrimin e babait. Biblën e vjetër dhe ariun e balsamosur pas shumë vitesh i trashëgoi djali i mesëm, jo i madhi.

Por në vitin 1891, i cili për familjen ishte vit kthese, kur senatori parandjeu afrimin e vdekjes dhe bëri testamentin, djali i mesëm, Tomasi, ishte vetëm gjashtëmbëdhjetë vjeç. Kur babai la amanet që firma të likuidohej, kishte parasysh gjendjen e saj të lëkundur, lodhjen e vet dhe, natyrisht, moshën e re dhe mungesën e përvojës së trashëgimtarit të mundshëm-Tomasit. Djali i dytë ishte

tip i përmbajtur, prandaj babai që po vdiste nuk e dinte atë gjë, të cilën vetë djali e kishte kuptuar qysh në mbarim të fëmijërisë. Prandaj, ditën e njëqindvjetorit të firmës Tomasin e mundonte një ndjenjë pikëllimi. Ai e kuptonte se nuk do të bëhej vazhdues i veprës së etërve në atë mënyrë që prisnin prej tij në heshtje dhe se nuk do ta çonte përpara firmën e vjetër. Por, duke gjykuar nga karakteristikat që senatori ka bërë në testament, duket se nuk i njihte mirë as djalin e madh, as bijat. Mos vallë janë të shumtë baballarët, të cilëve jeta nuk ua ka përgënjeshtuar parashikimet që kanë bërë për fëmijët e vet?

Por, le të flasim për testamentin. Si njeri me ndjenjën e disiplinës dhe detyrës që ishte, testamentin e shkruan në prag të operacionit kirurgjik. Nuk është i vjetër, është vetëm pesëdhjetë e një vjeç, por vetëpërmbajtja, me të cilën lan llogaritë e fundit me jetën, është për t'ia pasur zili edhe një plak i moçëm. Është mësuar që gjithçka ta parashikojë dhe për gjithçka të përgjigjet, dhe nuk e harron këtë zakon as në prag të vdekjes. Sipas tij, urdhëri për likuidimin e firmës nuk do të thotë thjesht pranim i mossaksesit të tij në tregti. Kjo do të thotë heqje dorë nga një çështje jetike, shkatërrim me duart e veta i asaj forme, sipas së cilës ka vazhduar qenia e të parëve të tij, qenia e atij vetë dhe tani për tani edhe e fëmijëve të tij, sido që ata të ngrenë krye kundër saj. Ai po e shkatërron duke respektuar plotësisht kërkesat e saj. U lë trashëgim nga njëmijë marka fondit muzeor të qytetit dhe fondit të sigurimit të vejushave të tregtarëve, nga tri mijë marka fondit të spitalit për ndihmëspeshuesit e drithit dhe fondit të hamajve, e kështu me radhë. Përgatit vetë një tekst të kursyer për njoftimin e vdekjes së vet, në emër të gruas:” Sot, në moshën pesëdhjetë e një vjeç, vdiq senatori Tomas Johan Hajnrih Man. Të afërmit në zi ju luten për ngushëllime të qeta. Julia Man (Bruns)”. Ai jep edhe udhëzime të tjera për organizimin: Dua që në arkivol kokën ta kem pak të kthyer djathtas, sikur fle. Në dorën e djathtë të kem një kryq të vogël të drunjtë ose të fildishtë, dora e majtë të prekë lehtë të djathtën. Nuk dua lule në duar, as duart kryq... Arkivoli më mirë të vendoset në dhomën e madhe të pritjes... Kur të fillojë ceremonia mortore mund të hapen

dyert që shpien në sheshin përpara shtëpisë... Muzika mund të jetë e njëjtë me atë të varrimit të nënës sime. Mundësisht, të ekzekutohet koralja “Merrmë për dore”, le ta luajnë”.

Senatori është mësuar me gjuhën e thatë dhe të saktë të kontratave dhe të korrespondencës së biznesit. Nuk e ka zakon që penën dhe bojën t’i përdorë për të derdhur emocionet. Kur flet për fëmijët, sidomos për djalin e madh dhe për vajzat, tronditjen dhe dhembjen i shpreh me fraza të kujdesshme, këshilluese, të qarta: “Kujdestarëve iu ngarkoj si detyrë të ndihmojnë në edukimin praktik të fëmijëve të mi. Duhet që, sa të jetë e mundur, t’i kundërvihen prirjes së djalit të madh për të ashtuquajturën veprimtari letrare. Mendoj se për të zhvilluar me sukses dhe me themel këtë veprimtari ai nuk i ka premisat: arsimin e mjaftueshëm dhe njohuritë e gjera. Arsyeja e vërtetë e prirjes së tij është shthurja prej ëndërrimtari dhe mungesa e respektit për të tjerët...Djalit të dytë nuk i mungojnë pikëpamjet e qeta, ka natyrë të mirë dhe do të gjejë profesion praktik. Me të drejtë shpresoj se ai do të jetë mbështetje për të ëmën. Për vajzën e madhe Julia, do të duhet të tregohet kujdes i madh. Natyra e saj e zjarrtë duhet frenuar. Kurse Karla, për mendimin tim, do të krijojë më pak telashe, dhe së bashku me Tomasin do të përbëjë një bazë të qetë”. Vetëm dy herë qëndresa e tradhton senatorin dhe helmi i ndarjes nga jeta i derdhet hapur nga kraharori- një herë kur përmend djalin e vogël, foshnjën motake: “Vikoja ynë i vogël, Zoti e ruajttë! Shpesh fëmijët që lindin vonë janë më të mbarë – djali ka ca sy aq të mirë.” Dhe herën e dytë, kur rikthehet te mendimet për djalin e mesëm, Tomasin. Për djalin e madh flet përsëri me tonin e njohur këshillues: “I lutem vëllait të ushtrojë ndikim mbi djalin tim të madh, që ky të mos futet në rrugën e gabuar, e cila do t’i sjellë fatkeqësi. Im bir duhet të mendojë për qëllimin e fundit dhe jo vetëm për dëshirat e tij të tanishme”. Pastaj senatori kalon menjëherë në fjalë të thjeshta, të dala nga zemra, pa tonin e matur: ”Tomi do të qajë për mua”. Më tej, testamentshkruesi përdor përsëri formula nga më të përgjithshmet, të cilat, sipas koncepteve të përvetësuar qysh në fëmijëri, i përshtaten stilit të shprehjes së vullnetit të fundit. Senatori shton: “Le të mos harrojmë t’i lutet Zotit, të respektojmë të

ëmën dhe të punojë me zell”. Por pas fjalëve “Tomi do të qajë për mua”, të cilat ngjajnë si një psherëtimë e pavullnetshme, edhe formulat e përgjithshme tingëllojnë si një amanet shumë personal, që buron nga marrëdhëniet midis këtij ati dhe këtij biri.

Ai vdiq nga një infeksion në gjak, jo disa ditë pas testamentit, por disa muaj më vonë. Nëse vendimi për likuidimin e firmës ishte pasojë e lodhjes, e zhgënjimit, e mosbesimit të e ardhmja, testamenti, i cili tashmë ishte legalizuar me firmat e noterëve, padyshim e acaronte gjendjen e vështirë të senatorit, ia priste edhe atë pak forcë për të jetuar që i kishte mbetur. Kur babai që po jepte shpirt i ndërpriste lutjet e pastorit me fjalën “amin”, Tomasit të pranishëm i dukej sikur me atë fjalë ai donte të thoshte: ”Boll, mjaft”.

Varrimi u bë po aq madhështor, sa edhe festimi i njëqindvjetorit të firmës.

Parashikimet e babait nuk u vërtetuan. Prirja e Hajnrihut për letërsinë nuk qe trill rinor, por thirrje e talentit në zgjim. Puna, të cilës Tomasi i kushtoi gjithë jetën, duke u bërë, ashtu si edhe Hajnrihu, një shkrimtar me famë botërore, nuk ngjante me asnjë nga ato profesione që, sipas pikëpamjes së senatorit, meritonin të quheshin “praktike”. Karla, që babait i dukej “bazë e qetë” e familjes, u bë aktore dhe, duke mos i duruar dot dështimet në skenë e në jetë, helmoi veten në moshën njëzetënjëvjeçare- gati dy dekada para vetvrasjes së motrës së madhe Julia, natyra e zjarrtë e së cilës, siç duket, jo më kot e shqetësonte babanë.

Babai, i cili kuptoi se Tomasi do të ishte mbështetja e ardhshme e vatrës familjare, gaboi vetëm lidhur me formën konkrete të vazhdimësisë të ky djalë, por dalloj me largpamësi se gjimnazisti gjashtëmbëdhjetëvjeçar jo fort i zellshëm kishte një besnikëri organike ndaj virtyeteve të kulturës byrgere të kultivuara në shekuj, siç janë dashuria për traditën dhe rregullin, ndjenja e fortë e detyrës, aftësia për të mbajtur fjalën dhe për të frenuar vrullin e pasioneve. Ai kuptoi se djali kishte shpirt të ngjashëm me të tijin, dhe nuk gaboi. Tomas Mani, në vitin 1926, kur babanë e tij prej kohësh e kishte tretur dheu, kurse vetë ishte aq vjeç sa ai në vitin e vdekjes,

erdhi në Lybekun e vet si shkrimtar për të festuar shtatëqindvjetorin e “qytetit të lirë”, ku pak kohë përpara kësaj feste i kishin dhënë titullin qytetar nderi. Dhe atje tha disa fjalë që dëshmojnë për lidhjen e tij të thellë morale me të atin:” Sa shpesh kam vënë re, madje e kam kapur veten në mendimin se personaliteti i tim eti më shërben fshehtas si shembull që përcakton gjithë sjelljen time...Nga babai kemi trashëguar “rreptësinë e rregullave të ndershme”, parimin etik, i cili në një masë të madhe përputhet me nocionin e atij byrger, qytetar... Parimi etik nuk e lejon artistin ta shikojë artin si çlirim nga të gjitha detyrat e njeriut, ai e detyron atë të krijojë shtëpi, familje, ta ndërtojë jetën e vet shpirtërore mbi themele të forta, të denja, sado ekstravagante dhe e çrregullt të duket ajo nganjëherë, me një fjalë, ta ndërtojë jetën mbi themele byrgere (përcaktim më të saktë nuk mund të gjej). Nëse kam vepruar dhe kam jetuar në këtë mënyrë, padyshim, rëndësi vendimtare për këtë ka pasur shembulli i tim eti; dhe ndonëse për krijimtarinë artistike dekoratat dhe titujt e jashtëm nuk kanë ndonjë rëndësi të veçantë, megjithatë sedra ime u përkëdhel disi, kur fare pak kohë më parë edhe mua - e kush mund ta mendonte! - më bënë “senator”, duke më zgjedhur anëtar të Akademisë Gjermane në Mynih”.

Por, edhe shumë kohë përpara këtij pohimi, në romanin e parë, ku pothuajse çdo personazh ka prototipin në historinë e familjes së autorit, heroit me tiparet e babait, senatorit Budenbrok, i ka vënë emrin e vet,-Tomas.

FËMIJËRIA, ADOLESHENCA...

Ai erdhi në këtë botë në shtëpinë e vogël me kopësht, pranë njërës nga portat e qytetit të Lybekut, ku senatori kishte dërguar për verim gruan shtatzënë me Hajnrihun katërvjeçar. Lindja e tij mesditën e një të diele qershori kaloi lehtë. Njëri prej miqve të familjes, shumë i dhënë pas astrologjisë, i cili bëri horoskopin e të porsalindurit, tha se pozicioni i mbarë i planeteve premtonte jetë të gjatë e të lumtur dhe vdekje të lehtë. Është qesharake që në kohën tonë t'u japim rëndësi këtyre profecive; edhe vetë Tomas Mani qeshte nganjëherë me parashikim e Oskar Shmicit, por megjithatë, edhe këtë emër e mbajti mend, edhe horoskopë të tjerë që përputheshin me atë të Shmicit i kujtonte, ndonëse me ironi, madje edhe lindjen e heroit kryesor të romaneve për Jozefin e përshkruan sikur ka ndodhur një mesditë të tillë vere. Përgjithësisht, i pëlqente gjithmonë interpretimi kuptimplotë i datave që lidheshin me jetën e tij. Për shembull, kur lexoi se Gëtja ishte bërë me karrocë personale në vitin 1799, menjëherë bëri shënimin në anë të faqes: “Në moshën pesëdhjetëvjeçare”. Është e qartë se në atë çast do t'i ketë shkuar ndër mend që edhe ai vetë ishte bërë pronar i një automobili në moshën pesëdhjetëvjeçare. Horoskopi nuk gënjeu: Tomas Mani jetoi deri në moshën tetëdhjetëvjeçare dhe pati vdekje të lehtë. Por me çfarë matet lumturia? Nëqoftëse do ta masim me sukseset, me gëzimin e punës, me shkrimin e librave të planifikuar, mund të themi me siguri se jeta e Tomas Manit ishte e lumtur...

Por përsëri kaluam shumë përpara.

Fëmijët e senatorit, faktikisht, rriteshin në dy shtëpi por, në krijimtarinë e shkrimtarit, gjurmën veçanërisht të thellë nuk e ka lënë vila elegante e ndërtuar në mbarim të fëmijërisë së tij, por shtëpia e vjetër me ballinë të lartë plot me zbukurime ku jetonte gjyshja, një patrice e vërtetë lybekase, vejushë senatori dhe nënë senatori. Shtëpia e gjyshes ndodhej (atje ndodhet edhe sot, e rindërtuar pas dëmtimeve të mëdha nga bombardimet në luftën e fundit) në një rrugicë me kalldrëm prej gurësh të mëdhenj që zbriste drejt shëtitores buzë Traves nga kodra, së cilës i qëndronte si kurorë

bazilika gotike e Shën Mërisë. Kjo kishë, Marienkirhe, dukej nga dritarja e shtëpisë dhe sundonte pothuajse krejt vendin përqark, duke theksuar kështu pamjen mesjetare të rrugëve, të cilat ishin të ngushta, me qoshe, nganjëherë edhe me emra që të kujtonin esnafet mesjetare si p.sh., e Derdhësve të Këmbanave, e Furrëtarëve, e Kasapëve.

Paul Tomasi, ky është emri i tij i plotë, ashtu si gjithë fëmijët e senatorit, u pagëzua në Marienkirhe, dhe po këtu, në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare, bëri krezmimin-ritin e pranimit të adoleshentit si anëtar me të drejta të plota të komunitetit kishëtar. Nuk ishte vetëm Marienkirhe me këmbanoren e saj dhe afreskët me subjekt nga “Vallja e Vdekjes”, nuk ishin vetëm këto shtëpi me çati majëmprehta, këto ledhe dhe porta hijerënda kështjelle, nuk ishin vetëm mbishkrimet latine, si për shembull mbishkrimi që binte në sy mbi hyrjen kryesore të shtëpisë së gjyshes-“Dominus providebit”, (“Zoti do të kujdeset”),- nuk ishin vetëm këto, gjërat që çdo ditë i tregonin djalit përrallën e frikshme për mesjetën gjermane. Mesjeta depërtonte në jetën e përditshme të qetë, të zakonshme, praktike të qytetit tregtar edhe nëpërmjet tablove të gjalla. Midis dyqaneve dhe tezgave të hijshme të shitjes së drithit gjithmonë mund të shikoje njerëz të çuditshëm të të dyja gjinive, të cilët jo se dukeshin si të çmendur, por si njerëz jashtë kohe, si të konservuar në atmosferën e vjetër gjermane të marrëzisë, ekstazës, frikërave mistike.

Në follenë e fisit të Manëve, në interierin e saj, ishte pasqyruar një epokë më e gëzueshme se ajo që ishte skalitur në qoshet e mprehta të Lybekut të gurtë. Këtë shtëpi e kishte blerë dhe e kishte mobiluar gjyshi i Tomas Manit, Johan Zigmundi i ri, afërsisht në kohën kur Johan Zigmund plaku, me energjinë dhe sigurinë e njeriut që diçka ka arritur, vizitonte gjërat interesante të Londrës dhe të Brabantit, me qëllim që, mbasi të kishte vëzhguar mënyrën e jetesës së të tjerëve, të huazonte atë çka i pëlqente dhe ta bënte më komode jetën në viset e veta. Në katin e dytë, pikërisht sipër mbishkrimit “Dominus providebit”, ishte salloni i pritjes, të cilin e quanin salloni i “peizazheve”, sepse në sixhadet e zbërdhylëta të murit ishin endur peizazhe idilike, në sfondin e të cilëve barinj dhe baresha flirtonin

dhe putheshin. Sixhadet, tavolina e bardhë e rrumbullakët me zbukurim ari, tryeza e shkrimit me stil të lajluar, koka e pruar e luanit në mbështetësen e divanit, qilimi me ngjyra të zbërdhylëta, sikurse ato të sixhadeve, kolltukët e bardhë – të gjitha këto ishin për nipin vrojtues një tregim i gjallë për paraardhësit, për besimin dhe krenarinë e tyre, për qëndrueshmërinë e patundur të mënyrës byrgere të jetesës, për aftësinë e tyre për të gëzuar frytet e shkathtësisë së vet dhe për mënyrën e tyre të të kuptuarit të së bukurës dhe të mirësjelljes.

“Fëmijërinë e kam pasur të lumtur, me pekule”,- thoshte Tomas Mani. Pjesa më e lumtur e fëmijërisë së tij mund të kenë qenë vitet para gjimnazit, sepse shkollën “e urrente”, dhe kur afrohej fundi i pushimeve i “këputej shpirti nga keqardhja sfilite për veten”. Lodrat dhe lojërat e para i kujtonte në moshë të pjekur. Në kujtime të tilla të vona vepron gjithmonë ligji i përzgjedhjes së pavullnetshme: në kujtesë ruhen më mirë ato hollësi, të cilat në njëfarë mënyre lidhen me formimin e mëtejshëm të karakterit dhe njeriut të pjekur i duken si parandjenjë e largët e pasioneve të tij të qëndrueshme, pra, si një hallkë e domosdoshme në zinxhirin e zhvillimit të tij. Prandaj, hollësitë e fiksuara në këto kujtime janë të rastësishme dhe fragmentare vetëm në dukje, kurse në fakt kanë një vlerë të madhe biografike.

Djali kishte lodra të mrekullueshme: një dyqan me banak, me peshore dhe me hambar të ngjashëm me hambarët e vërtetë buzë Traves; pajisje kalorësi prej kartoni; uniformë husari; ushtarë të vegjël prej kallaji; një kalë-përkundës me emrin Akil. Në shtëpi kishte edhe një komplet pajisjesh për teatër kukllash. Djali i vizatonte “aktorët”, i priste dhe i mbërthente në mbajtëse të vogla druri, luante rolet e dirigjentit dhe të shikuesve, imitonte veglat muzikore, duke u dhënë aq shumë pas kësaj loje, saqë orët që ia kushtonte kësaj zbatimjeje i dukeshin orët më të mira të jetës. Kurse pajisjet e kalorësit, uniforma e husarit dhe ushtarët e vegjël nuk i jepnin shumë kënaqësi vogëlushit. “Gjithë kjo maskaradë ushtarake,- citojmë kujtimet,- kurrsesi nuk krahasohej me gëzimin e shndërrimit në artist dhe në dirigjent”. Edhe dashurinë për kalin Akil

e kishte krejt të ndryshme nga dashuria e një kalorësi. “E doja thjesht si një qenie të gjallë, doja gjithçka që kishte: qimet e tij, patkonjtë e tij, flegrat e hundës së tij, e doja ashtu siç doja qentë prej porcelani, brumë letre dhe biskote, të cilat në fëmijëri m’i dhuronin me shumicë”.

Forcën e këtyre përshtypjeve të fëmijërisë dhe qëndrueshmërinë e prirjeve të shfaqura në këtë sjellje ndaj lodrave do ta konfirmojë në të ardhmen krijimtaria letrare. Teatri i kukllave do të bëhet pasioni kryesor i fëmijërisë së heroit të hutuar dhe jopraktik të novelës “Palaçoja” dhe do të luajë një rol të dukshëm në jetën e shkurtër të heroit të “Budenbrokëve”, vogëlushit Hano. Në tregimet dhe romanet, dashuria për kalin Akil do të shprehet në përshtypjet plot dhembshuri të gjithfarë “krijesave të gjalla”, të qenve, deveve, gomaricës. Qëndrimi mospërfillës dhe skeptik ndaj trimërive kalorësiake dhe luftës, i cili ishte shprehur në indiferentizmin ndaj helmetës me vizierë dhe uniformës së husarit, do t’i japë ngjyra ironie të “Doktor Fausti” figurës së Shildknapit, përkthyesit-anglist që ambicien e vet të pakënaqur e kënaq duke ia mbushur mendjen vetes dhe të tjerëve se gjoja të parët e tij kishin qenë shqytarë kalorësish dhe princash.

Por, argëtimi më i mirë i djalit, po të kemi parasysh jetën e tij të mëvonshme, ishin lojrat që nuk kërkonin fare mjete ndihmëse të jashtme dhe që bazoheshin vetëm te forca dhe pavarësia e fantazisë së tij. “Për shembull, zgjohesha në mëngjes i sigurtë se atë ditë isha një princ tetëmbëdhjetëvjeçar i quajtur Karl. Merrja një pamje madhështore, denjuese e të sjellshme, dhe vërtitesha krenar e i lumtur, i kënaqur me të fshehtë të dinjitetit tim. Edhe gjatë mësimit, shëtitjeve apo leximit të përrallave për asnjë çast nuk e ndërprisja lojën time, sepse aty ishte gjithë kënaqësia”. Veç kësaj i pëlqente ta përfytyronte veten si ndonjë perëndi e lashtë – si Zeusi, si Hermes. Kuptohet, kjo zbavitje ishte rrjedhim i njohjes me “Iliadën”, ashtu siç ishte dhe zgjedhja e emrit për kalin përkundës. Por loja perëndish dhe loja princash kishin të përbashkët në thelbin e vet ndjenjën e të qenit i zgjedhur, të cilën djali e kishte siç e kanë pothuajse të gjithë fëmijët, dhe të cilën, si pak fëmijë, e ruajti përgjithmonë. Krahasimi

i artistit me princin dhe i tregimtarit epik që zotëron lirisht materialin dhe gjuhën, me perëndinë, ka luajtur një rol aq të madh në jetën dhe krijimtarinë e Tomas Manit sa që, kur flitet për biografinë e tij, nuk mund të mos përmenden këto dy lojëra të fëmijërisë.

Në kohën e pashkëve të vitin 1882, ende pa mbushur shtatë vjeç, djali shkoi në shkollën fillore private të doktor Buseniusit. Shkollën e urreu qysh ditën e parë, sepse ajo i dha fund lirisë së tij fëmijërore. Shkolla i dukej mishërimi i armiqësisë së madhe të jetës ndaj njeriut, dhe detyrimi për të dalë nga shtëpia çdo mëngjes, për të pritur derisa të mbaronte ora e fundit e mësimit që pastaj të ishte i lirë të largohej nga mësuesit e rreptë dhe bashkëmoshatarët e zhurmshëm e të zhytej në vetminë e vet ëndërrimtare, ishte për atë diçka e tmerrshme gjatë gjithë viteve të shkollës, por veçanërisht në fillim e mundonte shumë.

Pikërisht në atë periudhë u dashurua fort pas gjumit, të cilin e kishte si strehë mbrojtëse nga telashet dhe mossukseset e përditshme. Nëse në vitet e mëpasme, ai binte në gjumë veçanërisht të thellë sa herë nuk i ecte puna apo sa herë i ndodhte ndonjë fatkeqësi e madhe, atë zakon e kishte fituar qysh kur mësoi për herë të parë të përmbledhë forcat nëpërmjet gjumit pikërisht në ato netë nga e diela te e hëna, të cilat ndanin ditën kur djali u përkiste plotësisht vetes dhe familjarëve të vet, nga dita, e cila e kërcënonte përsëri me “bezdinë e madhe që i shkaktonin të huajt”.

Pikërisht në atë kohë filloi t’i pëlqente shumë t’i kalonte mbrëmjet me nënën. Zakonisht ajo ulej pranë llampës dhe lexonte me zë përrallat e Andersenit apo fragmente nga romani i madh i Fric Rojterit “Bashkëvendësit e mi”. Kjo epope mbi jetën e landit të Meklenburgut, fqinjët lindor të Lybekut në bregdetin baltik, u pëlqente dëgjuesve të vegjël për humorin me të cilin ishin shkruar faqet kushtuar fëmijëve dhe për riprodhimin e saktë dhe zbavitës të dialektit meklenburgas.

Tomasit iu ngulit përgjithmonë në kujtesë kontrasti midis tingëllimit të ashpër të fjalëve të dialektit verior dhe kontureve ekzotike të gojës së nënës që shqiptonte ato fjalë. Ky kontrast ishte i shpjegueshëm, sepse në damarët e nënës, përveç gjakut baltik,

rridhte edhe gjak latin. Julia da Silva-Bruns (ky ishte mbiemri i saj i vajzërisë) vërtet ishte rritur në Lybek, por ishte lindur në Brazil. Ajo ishte bijë e një pronari plantacionesh gjerman dhe e një brazilianeje me origjinë portugezo-kreole...Djalit i pëlqenin më tepër mbrëmjet kur nëna muzikonte, kur, duke luajtur në piano, këndonte këngë të Shubertit, Shumanit, Bramsit, Listit, kur luante etyde dhe nokturne të Shopenit.

Por gëzimi më i madh i viteve të gjimnazit ishin pushimet e verës që i kalonte çdo vit në qytezën klimaterike Travemynde. Atje për herë të parë pa detin, për herë të parë dëgjoji muzikën orkestrale. “Në Travemynde, gjatë këtyre pushimeve parajsore, padyshim, kam jetuar ditët më të mira, më të lumtura të jetës sime, ditë dhe javë plot gëzim e shkujdesje, të cilave deri më sot asgjë s’ka mundur tua kalojë e t’i errësojë”.

Mbasi kreu gjashtë klasë në shkollën e doktor Buseniusit, vazhdoi studimet në gjimnazin e shkencave të sakta dhe natyrore “Katarineum” të Lybekut. As kjo shkollë nuk i pëlqeu. Mbeti dy herë në vitin e dytë dhe nuk e shtyu dot deri sa të merrte dëftesën e mbarimit, aq më tepër që edhe rrethanat e reja familiare i jepnin shkas ta linte gjimnazin sa më shpejt.

Po si shpjegohet gjithë kjo neveri për shkollën? Brenda mureve të trasha prej tulle të kuqe të “Katarineumit”, të ngritura qysh në shekullin XVI, fryma burokratike dhe sistemi i rreptë i mësimit dhe i edukimit ishin shumë të forta në kohën kur Tomas Mani ishte nxënës i saj.

Lëkundjen e themeleve të shoqërisë drejtorja e shikonte edhe te çapkënlleqet e zakonshme të fëmijëve. Si rregull, marrëdhëniet nxënës-mësues ndërtoheshin mbi bazën e nënshtrimit absolut të nxënësve ndaj mësuesve. Kulturi i forcës, i cili në Gjermani lulëzonte pas fitores mbi Napoleonin III (përvjetoret e betejës së Sedanit festoheshin me pompozitet të madh), ndjehej brenda këtyre mureve edhe në tonin, me të cilin nxënësit më të rritur flisnin me më të vegjëlit, edhe në atmosferën e mësimëve të gjimnastikës, edhe në atë mënyrën kategorike, me të cilën mësuesit dhe edukatorët përkrahnin nxënësit beniaminë.

Budallallëku dhe mediokriteti mikroborgjez i disa prej drejtuesve të arsimit popullor në Lybek shprehet edhe në një ndodhi që Tomas Mani e kujtonte në pleqëri me buzëqeshje. Njëherë, në sallë, tek qortonte disa çamarrokë që kishin gërvishur me brisk tavolinat dhe bankat e klasës, drejtori i gjimnazit u tha rreptë: “Ju jini sjellë si social-demokratë!” Të gjithë ia plasën gazit, madje edhe disa mësues, por drejtori bërtiti:” S’ka gjë për të qeshur!”.

Qysh në vitin e parë në “Katarineum”, nxënësi i ri katërmbëdhjetëvjeçar Tomas Man e uli shumë reputacionin e vet para drejtorisë së gjimnazit. I shtyrë nga sqima fëmijërore, i mburr një nxënësi duke i thënë se shkruante vjersha, mirëpo ky njoftoi kujdestarin e klasës. Sipas mësuesve, shkrimi i vjershave, nëse nuk ishte një punë e barasvlershme me “përmbysjen e themeleve”, të paktën ishte një punë e dyshimtë, e parespektuar, e padenjë për birin e një babai aq të nderuar. Vjershëtorin e ri e shikonin me mosbesim, kurse senatorin -dikush me simpati, dikush me ligësi.

Detyra e përditshme për t’ua nënshtruar jetën e vet kërkesave të “shkollës” ia prishte humorin adoleshentit. Siç e shikojmë, ambicia e tij letrare ishte e mjaftueshme për t’iu mburrur shokut për vjershat. Ai së bashku me motrat luante në shtëpi para prindërve dhe të afërmve pjesë teatrale që i shkruante vetë. Por për ta braktisur gjimnazin i nisur nga këto shenja të para të antipatisë për “veprimtarinë praktike”, për t’iu thënë vendosmërisht në fillim vetes e pastaj babait se dëshironte t’i jepte fund këtij mësimi mekanik, këtij sistemi të rreptë edukimi, kësaj mërzie, ai nuk mundte, nuk e bënte dot. Çfarë e lidhte pas rutinës së urryer? Mos vallë ndjenja e detyrës përpara babait, i cili e kishte zgjedhur si trashëgimtar të firmës, apo ndjenja e detyrës përpara jetës në përgjithësi, e cila kërkon nga të gjithë përpjekje dhe sakrifica të pakëndshme? Mos vallë vetëdija e fshehtë se krijimet e para nuk ishin të përsosura? Apo dyshimi se mbi një themel të tillë të dobët nuk do të mundte të ndërtonte të ardhmen? Mos vallë forca e mendimit të familjes se matësi kryesor i suksesit ishte mirëqenia materiale,- mendim nga i cili adoleshenti që nuk shquhej për asgjë nuk e kishte aq të lehtë të

shkëputej. Siç duket, te ai ndikonin të gjitha këto arsye së bashku. Prandaj edhe humorin e kishte të prishur.

Korfiç Holmi që do ta takojmë përsëri në tregimin tonë dhe që ka qenë nxënës i “Katarineumit”, një klasë më lart se Tomas Mani, në kujtimet e tij të titulluara “Unë me “u” të vogël”, përmend një fakt që tërthorazi dëshmon se kjo mendësi ishte karakteristike për vitet e tij të gjimnazit: “Ndoshta garancia e vetme e pavdekësisë sime është që unë bashkë me atë formoja një çift në orën e gjimnastikës...Tomas Mani si gjimnazist, po të flasim për aftësinë dhe dëshirën e tij, përbënte një rast të veçantë: ndaj kësaj marrëzie bënte një qëndresë pasive, krejt të pavarur, paralelet dhe hekurin e këtyre objekteve të padenja për të i prekte me majë të gishtave, sa për të thënë, u hidhte një shikim me të vërtetë të verbuar nga përçmimi...”.

Siç duket, loja princash e fëmijërisë ka qenë thjesht parandjenjë e gjendjes shpirtërore të adoleshencës. Duke mos pasur ende në vetvete forcat dhe vendosmërinë e duhur, duke mos parë ende, për shkak të moshës së re, ndonjë mundësi për ta ndërtuar jetën e përditshme në përputhje me prirjet e veta, -por as këto prirje nuk i shquante qartë, dhe armiqësinë ndaj shkollës e kishte më të fortë sesa pasionin për letërsinë,- ai ndiente në nënvetëdijë që kjo mospërputhje ishte e përkohshme, dhe e ndërmjetme.

Megjithatë, nuk mund të themi se në jetën e tij shkollorë s’kishte gjëra të gëzueshme. Ndër dhaskalët e gjimnazit, më simpatiku ishte mësuesi kujdestar Betke, i cili jepte gjermanishten dhe latinishten. Betkeja e mbante veten për luftëtar i përparimit, madje edhe për opozitar politik. I pëlqente të mbante fjalime në bashkinë e qytetit dhe, edhe për gjërat më të parëndësishme, nuk linte rast pa sharë administratën më të lartë: senatin. Këto fjalime zakonisht mbylleshin me sentenca franceze, të cilat oratori, sipas zakonit të mësuesit, i përkthente menjëherë në gjermanisht.

-Quis’ excuse, s’accuse,-llomotiste Betkeja,- që do të thotë: “Kush kërkon falje, akuzon veten”, zoti senator.

Mendimet e lira të natyrshme Betkeja i shpaloste edhe me këtë gojëtar të çuditshme, edhe me entuziazmin, me të cilin u rekomandonte nxënësve baladat e Shilerit:

– Këto nuk janë lexime dosido, por janë gjërat më të mira që do t’iu bien ndonjëherë në dorë për të lexuar!

Mësuesi liberal i shkencave humane Betke, tiparet e tij prekëse e qesharake, mos vallë edhe ato janë përfshirë në figurën e Setembrinit të “Mali magjik”?

Jetën në “Katarineum” e zbukuronin edhe miqësitë me shokët, njëra prej të cilave, miqësia me shokun e klasës Oto Grautof, bir i një tregtari librash nga Lybeku, i cili më vonë u bë shkrimtar dhe kritik arti, lindi pikërisht nga neveria për gjimnazin. Kurse një shok tjetër, një bukurosh, sportist dhe nxënës shembullor, (për të dihet vetëm që shërbeu si prototip i djalit flokëverdhtë e vithengushtë Hans Hansen të “Tonio Krögeri”, kurse në realitet u bë pijanec) e tërhiqte autorin e ardhshëm të kësaj novele pikërisht sepse nuk kishte ngjashmëri me atë vetë, dhe, pa e kuptuar, i fuste në jetën e tij të zymtë shkollore shqetësimin e këndshëm të një të dashuruari të vërtetë.

Qysh fëmijë dinte t’i admironte njerëzit, muzikën, librat, detin, dhe, më vonë, thoshte se arritjet e tij në art ishin bërë të mundura falë aftësisë për të admiruar gjërat e të tjerëve. Arkitektura mesjetare, koncertet në klubin e Travemyndes, shoku i klasës, vajza me gërshetkat bojëgështenjë, me të cilën nxënësi i klasës së ulët të “Katarineumit” u njoh në mësimet private të vallëzimit dhe së cilës i kushtoi disa poezi që fatkeqësisht kanë humbur - këto, siç duket, janë përshtypjet estetike më të forta të fëmijërisë, nëse kemi parasysh përshtypjet e mirëfillta nga Lybeku, dhe jo ato nga librat.

Në këtë listë të shkurtër kurrsesi nuk mund të fusim emrin e poetit Emanuel Gaibel, qytetar nderi i Lybekut, njeri me të vërtetë i pandarë nga qyteti i lindjes, sepse këtu jo vetëm e njihnin të gjithë kur ishte gjallë, por pesë vjet mbas vdekjes, më 1889, lybekasit i ngritën përmendore. Një letër e Tomas Manit, e para letër për të cilën kemi dijeni, i takon vitit të përrurimit të kësaj përmendoreje dhe mban nënshkrimin “Tomas Man, poet liriko-dramatik”. Ky

vetëvlerësim i parë ironik (sa shumë të tjerë do të pasojnë në artikuj dhe letra!) është një aluzion i përmbajtur për Gaibelin. Sepse poet i njohur liriko-dramatik nuk ishte gjimnazisti katërmëdhjetëvjeçar, por origjinali i monumentit, vdekja e të cilit, siç thoshin, kishte bërë që një grua plakë të pyeste në rrugë e shqetësuar:” Cilin do të caktojnë tani në vend të tij?”. Autori i ri nuk kishte dëshirë të zinte vendin e epigonit të nderuar që me lirën e tij nacionaliste kishte fituar titullin e kasnecit të shtetit.

Në vitin 1868, me rastin e vizitës në Lybek të mbretit prusian Vilhelm, i cili tre vjet më vonë u bë kaizeri gjerman Vilhelmi I, Gaibeli shkroi një odë prej nënshtetasi besnik.

Në vitet tetëdhjetë, me sa duket tranzit për në Hamburg, Vilhelmi I u shfaq përsëri para byrgerëve lybekas në qytetin e tyre. Treni i posaçëm i kaizerit ndaloi për pak minuta nën çatinë e tymosur të stacionit. Vogëlushi Tomas Man ndodhej në platformë dhe i nguliti thellë në kujtesë ato që pa dhe dëgjoi atje. Në vagonin-sallon vuri re një plak thatim me një kasketë ushtarake tepër të madhe, e cila vazhdimisht i shkiste dhe binte përtokë. Kur kaizeri ngriti dorën për të përshëndetur, majat bosh të gishtave të dorashkës, e cila gjithashtu ishte tepër e madhe, tundeshin në ajër. Skena në platformë i la Tomas Manit një mbresë aq të thellë, saqë edhe mbas shumë vitesh, për humor, ua riprodhonte shpesh fëmijëve të vet.

Gjimnazisti ende nuk dinte si duhej shkruar, por dinte që si Gaibeli nuk duhej shkruar.

Kurse shteti i dukej vogëlushit si një person që bënte një jetë të huaj të pakuptueshme diku larg atij. Po, i dukej si një person, sepse në përfytyrimin e tij ai e “personifikonte”, e përfytyronte si një figurë të rreptë e të ngurtë, të veshur me frak, me mjekër të madhe, me yll në gjoks, e përfytyronte si një figurë të mbuluar me një përzierje titujsh ushtarakë dhe akademikë, e cila kishte për qëllim të shprehte forcën dhe dinjitetin e tij – si njëfarë gjeneral-doktor fon Shtat³.

³ Staat – shtet (gjerm.)

...DHE RINIA

Thamë që viti 1891 ishte një vit kthese për familjen. Menjëherë pas vdekjes së babait (ai vdiq në vjeshtë) pasuan likuidimi i firmës dhe shitja e vilës. “Shtëpinë e madhe, -kujtonte Tomas Mani,- me sallonin e pritjes, ku oficerët e garnizonit vendor vallzonin mbi parket dhe u bënë korte vajzave të patricëve, e ndërruan me një më të vogël, me një vilë në mes të një kopshti jashtë portave të qytetit”. Tomasi po përgatitej të ndahej nga familja tashmë e pakësuar në numër. Kishin vendosur që në këtë banesë të re nëna dhe fëmijët e vegjël (pas varrimit Hajnrihu kishte shkuar në Drezden) të jetonin deri në pranverë dhe pastaj në kohën e pashkëve të transferoheshin në Mynih, kurse Tomasi të qëndronte në Lybek për të vazhduar gjimnazin.

Në dimrin e vitit të ri 1892, parandjenjën e ndryshimeve e vërtetoi jo vetëm perspektiva tashmë e qartë e shkëputjes nga Lybeku, por edhe një përshtypje e madhe estetike që nuk e kishte pasur ndonjëherë më parë. Kemi parasysh takimin e tij të parë me artin e Rihard Vagnerit, art, i cili për Tomas Manin u bë “një ngjarje artistike themelore e jetës” dhe i cili, falë aftësisë së tij për të admiruar gjërat e të tjerëve, e tërhiqte ashtu siç e tërhiqnin krijimtaria e Gëtes, filozofia e Shopenhauerit dhe ajo e Niçes. Ky takim ndodhi në teatrin e qytetit të Lybekut, ku në sezonin e vitit 1891/1892, ishte ftuar tenori Emil Herhojzer. Herhojzeri më shpesh këndonte Loengrinin, atë kishte rolin ku shkëlqente. “Nuk dua të jem jomodest,-shkruante Tomas Mani,- por mendoj se brenda mureve të teatrit të qytetit nuk ka pasur kurrë dëgjues më me ndjenjë dhe më të entuzizuar sesa unë në ato mbrëmje të magjishme”. Përse themi që njohja me muzikën e Vagnerit vërteton parandjenjën e ndryshimeve? Në motivet e saj të përsëritura, që duket sikur citojnë vetveten dhe marrin kuptim simbolik, “poeti” i ri “liriko-dramatik” gjeti një ngjashmëri mahnitëse me idealin e vet të mjegullt të formës artistike. As përrallat e Andersenit, as “Don Karlosi” i Shilerit, as vjershat e Hajnes – vepra këto që gjithashtu i donte shumë,- nuk patën veprim të tillë stimulues mbi prirjen e tij

për krijimtari letrare, sa patën operat e Vagnerit. Ato e mbushën menjëherë “me dëshirën e zjarrtë, të përzier me zili dhe pasion për të bërë diçka të ngjashme, qoftë edhe të vogël e të qetë”. Muzika e Vagnerit, i cili kishte vdekur në vitin 1883, ishte për fundshekullin një fjalë e re në art, dhe Tomas Mani i ri e shikonte Vagnerin si bashkëkohës më të vjetër, e meqënëse në rini ishte veçanërisht i ndjeshëm ndaj të resë, vetëm arti i atij, duke e afruar apo duke e larguar, duke i ngjallur dëshirën ziliqare për të imituar apo për të polemizuar, ia shpalos qartë të dhënat dhe shijet që ka ai vetë, i tregon se ç’drejtim duhet të marrë. Duke vërtetuar me ekzistencën e vet se në një vepër arti figuracioni konkret mund të ndërthuret me përgjithësimin skeptik, i cili e shndërron në mit objektin e simbolizuar, muzika e Vagnerit vërteton atë çka gjimnazisti që ëndërronte lëmin e artit arrinte ta nuhaste turbullt. Ajo që e para që i qartësoi synimet e tij, e ndihmoi të forconte ndjenjën instiktive se ato ishin synime të drejta. Ai dëgjoi thirrjen e saj të fuqishme për krijimtari.

Largimi i nënës, i motrave dhe i vëllait të vogël e bëri më të pavarur në jetën e përditshme. Dy vjet i kaloi në Lybek pa familjen, te mësues të ndryshëm të gjimnazit, të cilët strehonin në konvikt nxënësit e ardhur nga larg. “Nga ajo kohë ruaj një kujtim të këndshëm. “Institucioni” nuk priste asgjë prej meje, më kishte dorëzuar në duart e fatit tim që për mua vetë ishte krejtësisht i turbullt, por që aspak nuk më brengoste me atë paqartësinë e vet sepse, pavarësisht nga të gjitha këto, e ndjeja që isha i zgjuar dhe i shëndetshëm. Orët e mësimi i bëja, kurse pjesën tjetër të kohës jetoja, si me thënë, në liri, me shokët e konviktit kaloja shumë mirë dhe...nganjëherë merrja pjesë në festat e tyre, të cilat vazhdonin me mbrëmjet studentore”.

Dhe ja, më në fund, për herë të parë, rreshtat e shkruar prej tij riprodhohen në shtypshkronjë. Ndonëse fillestar në letërsi, del me pseudonim, por pseudonimi “Paul Tomas”, në të cilin pjesën e dytë të emrit të vërtetë të plotë e paraqet thjesht si mbiemër, aludon qartë për autorësinë dhe shpreh mosdashjen e debutuesit për t’u shkëputur krejtësisht prej prodhimit të vet, shpreh qëndrimin e tij serioz ndaj

fjalës së botuar. Pseudonimi, padyshim, i është dashur për t'iu shmangur thashethemeve të kota që mund të shkaktonte mbiemri “Man”, i cili në Lybek njihej aq mirë nga të gjithë.

Filloi të botojë qysh në gjimnaz, në qytetin e lindjes, vitin e fundit në Lybek, i cili, pas fëmijërisë, ishte për të viti i lirisë dhe i shkujdesjes më të madhe. Në maj të vitit 1893, bashkë me disa maturantë të “Katarineumit” (klasë mature ishte e pesta, kurse Tomasi atëherë ishte në klasën e katërt, pas së cilës e la shkollën fare) filloi të botojë një revistë të vërtetë. Redaktorë të numrit të parë ishin Paul Tomasi dhe Oto Grautofi, kurse numrin e dytë e redaktoi Paul Tomasi vetëm. Autorë të vjershave dhe artikujve ishin ata vetë, Korfic Holmi që e kemi përmendur dhe dy gjimnazistë të tjerë. Nuk e dimë sa i madh, apo më saktë sa i vogël ishte tirazhi dhe me çfarë kushtesh shtypshkronjat e Lybekut u kishin vënë në dispozicion këtyre fëmijëve bazën poligrafike. Revista quhej “Stuhia e pranverës” dhe në titull iu prezantua lexuesve si “e përmuajshme letraro-artistike dhe filosofike”. Botuesit, siç duket, nuk e vrisnin shumë mendjen për të ardhmen. Pa thënë, pastaj, që numri tjetër i të përmuajshmes nuk mundi të dilte në kohë për shkak të pushimeve verore, dhe redaktori ua shpjegoi sinqerisht arsyen pajtimtarëve kur e shpërndau më në fund në gusht (dyfish-për qershorin dhe korrikun bashkë). Me këtë numër të dytë revista pushoi së ekzistuari. Është në nderin e tyre si botues që nuk e mbanin veten për letrarë profesionistë dhe me përvojë. Përveç arsyes së pushimeve verore, për sinqeritetin e tyre rinor flet, për shembull, edhe recensionin i Paul Tomasit për vënien në skenë të operetës së Milekerit “Fatlumi” në teatrin e qytetit të Lybekut. Nga ky recension lexuesi mund të gjykojë me saktësi për profesionin kryesor dhe për moshën e recensentit. “Nëse është fjala për idiotizëm, të paktën të jetë me vend. Ky është një parim absolutisht i drejtë. Ja përse nuk më pëlqen të shkoj në shkollë. Atje të gjitha gjërat janë gjysmake. Kurse te “Fatlumi” idiotizmi ka një logjikë mahnitëse, prandaj kjo, padyshim, është një pjesë e lavdërueshme dhe aspak e kritikueshme nga pikëpamja estetike. Madje aty citohet edhe Ibseni. Për mendimin tim, më tepër nuk mund të kërkohet”.

Jo, jo, gjimnazisti me penë kaq të mprehtë nuk e fshihte moshën e vet të re, përkundrazi, e deklaronte duke e identifikuar me armiqësinë ndaj amullisë shpirtërore, me çlirimin nga paragjykimet. Parathënia e shkurtër e Tomas Manit për numrin e parë të “Stuhisë së pranverës” është në kuptimin e vërtetë të fjalës një lëvdatë për vrullin rinor dhe një qortim për rutinën. Ajo nuk përmban kurrfarë deklaratah programatike konkrete. Në parathënie vërtet flitet për “ideale të ndritura” dhe, duke u nisur nga nëntitulli i së përmuajshmes, mund të arrihet në përfundimin se idealet që ka parasysh janë, para së gjithash, idealet estetike, por autori i ri ende nuk është në gjendje t’i përcaktojë ato me fjalë më pak të përgjithshme dhe më të sakta, sesa një epitet i vetëm i fryrë. Por një gjë është e qartë - ai dëshiron që për gjithçka të gjykojë sipas mënyrës së vet. Ja parathënia:

“Stuhia e pranverës!

Lybeku ynë i nderuar është një qytet i shkëlqyer. Po, po, një qytet i mrekullueshëm! Megjithatë shpesh më duket se i ngjan barit të mbuluar nga pluhuri, i cili pret stuhinë e pranverës t’i shpëtojë jetën nga pështjella mbytëse. Sepse jetë këtu, ka! Kjo s’ka dyshim, kjo duket nga disa filiza të gjelbër që çajnë shtresën e pluhurit sepse janë të mbushur me forcë rinore dhe frymë luftarake, janë pa paragjykime dhe plot ideale të shkëlqyera.

Stuhia e pranverës! Po, ashtu si sulet mbi tokën e pluhurosur stuhia e pranverës, ashtu do të sulemi edhe ne me fjalën dhe mendimin tonë mbi botën e mendjeve të pluhurosura, mbi botën e paditurisë dhe filistinizmit mediokër e fodull që bëhet pengesë në rrugën tonë. Kjo është dëshira e revistës sonë, kjo është dëshira e “Stuhisë së pranverës”...”.

Kushdo që e njih sadopak letërsinë gjermane, në këtë antitezë të qytezës hijerëndë të kredhur në letargji mendore dhe rinisë së etur për fluturime shpirtërore, do të dallojë një ngjashmëri të madhe me faqet e para të “Udhëtimit në Harc” të Hajnes. Atje – Gëtingeni, këtu – Lybeku, atje- “dua të ngjitem maleve”, këtu- “si stuhia e pranverës dua të sulem mbi botën e mendjeve të pluhurosura”. Paul Tomasi e imiton dukshëm Hajnen edhe në dy vjersha lirike të botuara te “Stuhia e pranverës”. Kurse vjersha e tretë është më e pavarur, më interesante, prandaj ia vlen të ndalemi në mënyrë të veçantë, aq më

tepër që ajo përmban disa tipare të vendit dhe të kohës kur u shkrua, tipare që këtë fakt letrar e afrojnë me faktet e jetës së përditshme.

Por në fillim të flasim edhe për diçka tjetër, për shprehjen më të drejtpërdrejtë dhe më të thellë të simpatisë së Paul Tomasit për Hajnen. Është fjala për recensionin e artikullit të njëfarë doktor Konrad Shipio të botuar në shtojcën e gazetës “Berliner Tageblatt”. Pra, gjimnazisti i provincës, në revistën e vet, si me thënë, artizanale, hyn në polemikë me një autor të gazetës së kryeqytetit, i cili ka edhe titull akademik. Ai “argumenton me forcë se është e domosdoshme që Hajne të falet për jetën private paksa të shpenguar pasi, thotë ai, në thelb është një protestant i mirë dhe patriot i mirë”. Ky argumentim primitivo-filistin i ngjall Paul Tomasit përbuzje dhe shpoti, prandaj ky nxënës i klasës së katërt e qorton doktorin, duke qenë i sigurt në epërsinë e vet mendore mbi atë. “Vallë vërtet ky njeri mendon se i bën nder pas vdekjes Hajnrih Hajnes, kur thotë banalitete të tilla?! Të bukura argumente! Meqenëse Hajneja flet me admirim për Martin Luterin, do të thotë se është protestant!...Hajnrih Hajneja, i dashur zoti doktor, pavarësisht se ishte gjerman, e admironte Napoleonin, dhe, pavarësisht se nuk ishte protestant, e admironte Luterin”. Për ta “rehabilituar” Hajnen, doktor Shipio e ka quajtur “njeri të mirë”. Lidhur me këtë, Paul Tomasi vëren:” Ndoshta e kam shumë gabim, por kam një zakonsapo dëgjoj shprehjen “njeri i mirë”, menjëherë e përkthej me mend në frëngjisht: un bonhomme”.⁴

Recensionin përfundon me konkluzionet sarkastike “Jo, Hajnrih Hajne nuk ishte njeri “i mirë”. Ai ishte vetëm njeri i madh... Vetëm i tillë!... Megjithatë, artikulli është kaq i thatë e kaq i zyrtar, saqë doktori meriton ta bëjnë profesor”.

Siç shihet, vetafirmimin e fillon me polemikë të ashpër, me diskutim të guximshëm, me grindje. I riu Tomas Man është kundër qasjes së ftohtë mikroborgjeze ndaj njeriut, e cila e shikon atë vetëm si një pjesëz të shtetit, është kundër gjykimit për njeriun duke u mjaftuar me vlerësimin e besnikërisë së tij si nënshtetas. Nëse ndaj

⁴ Ileshko (frëngj.)

Gaibelit djaloshi ishte krejtësisht indiferent, ndaj doktor Shipios që ndjek të tilla kritere për vlerësimin e një njeriu të madh, një poeti gjenial, djaloshi është fshikullues.

Protesta kundër mediokritetit mikroborgjez rritet dhe shndërrohet në protestë kundër kritereve sociale. Duke e mbrojtur Hajnen nga vlerësimet banale e shabllone, Paul Tomasi i kundërvë ambientit artistin në përgjithësi, e shkëput atë nga historia, e absolutizon personalitetin e tij. Kjo nuk është harxhim i kotë i një polemike të bërë me pasion gjysmëfëmijëror, por shprehje e sinqertë e një perceptimi të caktuar të botës, i cili buron nga ndjenja e shqetësimit të artistit në shoqërinë byrgere. Në këtë rast shqetësimin e ndiente njeriu që ende ishte vetëm një artist potencial. Më vonë Tomas Mani nocionet “i mirë”, “i keq”, si dhe nocioni “patriotizëm” nuk do t’i duken aq të ulëta e primitive, ato do të mbushen me përmbajtje dhe kjo përmbajtje do të ndryshojë. Por përparësia e vlerësimit estetik të njerëzve dhe situatave mbi vlerësimin social-historik të tyre do të mbetet për shumë kohë veçoria e penës së tij kritike dhe artistike.

Në numrin e parë të “Stuhisë së pranverës” autori me pseudonimin Paul Tomas botoi vjershën “Dy lamtumirat”, të cilën pak më vonë e ribotoi në një revistë të vërtetë letrare me mbiemrin e tij të vërtetë.

Ajo ishte mbrëmja e fundit. Ne shetisnim
Gjatë bregut. Tek nxinte, në pafundësi
Deti largohej në heshtje. Në qiellin gri
Asnjë yll nuk dukej.
Nuk dukej as ylli i shpresës
Për takim...

Kjo është lamtumira e parë, pa dëshmitarë, në bregun e shkretë të detit, nën dritën e kuqe të zbehtë të farit që vezullonte në largësi. Qetësinë e natës së lagësht të verës e prishin vetëm fjalët: “Fund...Përjetë...”. Cili prej atyre të dyve i ka shqiptuar, nuk dihet. Por tingulli i tyre i qetë e i trishtuar qëndron pezull në ajër.

Pastaj erdhi mëngjesi. Në stacionin e vogël
Gulçonte treni që kishte pritur gjatë. Nxitim,
Zhurmë, rrëmujë e përbaltur
bagazhesh të qullura, fytyrash të lagura
dhe avulli...

Kjo është lamtumira e dytë. Ai mban në dorë një buqetë. Ajo është aty bashkë me prindërit e vet. Ai dhe ajo i thonë njeri tjetrit vetëm gjëra që duhen thënë në rrethana të tilla: “Sa lule të bukura”, “S’na mbajti mot i mirë”, “Mirupafshim”, “Gjithë të mirat”. Ajo ikën.

Të dy gënjenim.
Por gënjeshtër më e madhe ishte:
“Mirupafshim”.
Që të dy e dinim atë që dëgjoi
Deti në atë mbrëmje vere të lagësht e të errët:
“Fund. Përjetë”.

Saktësia e hollësive të ngjarjes, përshkrimi natyralist i mjedisit që e rrethon në një stad kaq të hershëm të veprimtarisë letrare dëshmojnë se vetë ngjarja është e vërtetë, e patrilluar. Siç duket, në jetën e Tomas Mani tetëmbëdhjetëvjeçar ky episod ka ndodhur me të vërtetë. Edhe të “Budenbrokët” ndarjes së përjetshme të dashuruarve Toni dhe Morten Shvarckopf i paraprin një skenë prekëse në breg të detit, në të cilën vërehet një përpunim më i pjekur pikërisht i kësaj përshtypjeje reale, ndjehet jehona e saj. Vjersha “Dy lamtumirat” paraqitet interesante jo aq sepse nga ana e jashtme duket autobiografike – e kush është ai që në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare nuk është dashuruar e nuk është ndarë nga objekti i dashurisë së vet? – ajo paraqitet interesante, sepse për autorin e saj është karakteristike rimarrja e temës së ndarjes. Theksi kryesor bie mbi vargun “Të dy gënjenim”. Problemi themelor është mospërputhja midis normave të sjelljes së diktuar nga rrethanat dhe mjedisi dhe vrulleve organike të shpirtit. Në dritën e këtij vargu tabloja e bregdetit të shkretë dhe tabloja e stacionit të rrëmujshëm e të zhurmshëm nuk janë thjesht vizatime nga natyra, por janë

përgjithësim, simbole të dy parimeve të kundërta. Nga njëra anë qëndrojnë shpirtërorja dhe delikatja, nga ana tjetër materialiteti shtypës dhe proza e jetës. Autori i ri ende nuk i kishte lexuar Shopenhauerin dhe Niçen. Do të kalonin edhe shumë vite, përpara se ta ndiente veten plotësisht të familiarizuar me terminologjinë filozofike dhe të përsëriste se më tepër nga gjithçka tjetër në botë e tërhiqte tendenca e shpirtit për shkrirje dashurore me materien, përpara sesa të thoshte se “deti nuk është peizazh”, por një figurë përjetësie, mosqenieje dhe vdekjeje, është një ëndërr metafizike”. Por, duke e mishëruar në poezi dhembjen e dashurisë rinore të pafat, ai operon me figura, të cilat kanë në logjikën e vet ogurin e interpretimit origjinal dhe të thellë të fakteve jetësore.

Kurse në mars të vitit 1894, ndoshta nga i njëjti stacion i vogël treni, ku heronjtë e vjershës ishin ndarë duke shkëmbyer gënjeshtër, u largua nga Lybeku edhe vetë autori. Erdhi në Mynih dhe u vendos te e ëma, pa mbaruar gjimnazin, pa plane të qarta për të ardhmen. Në prill Tomas Mani gjendej i ulur te tavolina e punës së “Bankës gjermanojuqore të sigurimit nga zjarri”, ku drejtori që ia njihte mirë të atin, e pranoi si stazhier, pa rrogë. Kështu, ai hyri në punë jo për të marrë rrogë por, siç ka thënë më vonë, sepse “i vinte zor që menjëherë dhe haptas të fillonte jetën në limonti”. Po të gjykojmë nga puna këmbëngulëse letrare e vitit të parë në Mynih, duhet thënë se ai nuk kishte aspak ndërmend të jetonte “në limonti” në kuptimin e vërtetë të fjalës, d.m.th. pa bërë gjë. Në fakt, nuk i vinte zor nga limontia, por nga opinioni i njerëzve për gjendjen, në të cilën ndodhej si njeri pa punë të përditshme të denjë për moshën dhe rolin e tij si bir tregtari me arsim gjysmak. Por edhe ai vetë, meqenëse ende nuk kishte arritur afirmimin e autoritetshëm të aftësive të veta prej shkrimtari, e shikonte veten jo vetëm në prizmin e parandjenjave krenare të pashprehura, por edhe me sytë e të ndjerit baba, me sytë e nënës dhe të kujdestarëve. Ky shikim i dyfishtë nuk është i lehtë, prandaj ai ra në kriza dëshpërimi, mendoi për vetëvrasje, humbi krejt besimin te jeta dhe te vetja. Por ai ishte ende mjaft i ri për të ruajtur gjendjen e vet shpirtërore mbizotëruese të ndryshimeve të reja në fatin personal, të cilat do të vinin pas atij

ndryshimi aq të rëndësishëm që tashmë kishte ndodhur – shpërngulja në Mynih. Më vonë kujtonte se kur punonte si stazhier në bankën e sigurimit thoshte me vete: “ Tani për tani kështu duhet”. Fillimisht, ndoshta vetë kontrasti midis Lybekut provincial pedant dhe atmosferës së kryeqytetit bavarez, në të cilën u zhyt ish shkollari, do ta ketë inkurajuar në rrugën e letërsisë, ku ai e kishte hedhur një hap të parë të vogël.

Bavaria, si edhe Lybeku, qysh prej vitit 1871 ishte pjesë e Perandorisë Gjermane, por mbahej si më e pavarur se landet e tjera gjermane dhe më se një herë në historinë e re të Gjermanisë i ka shprehur hapur synimet e veta separatiste. Vitet nëntëdhjetë ishin mesi i së ashtuquajturës epokë e regjencës: Napoleoni u kishte dhënë titullin mbretëror dukëve bavarezë, pushteti mbretëror në Bavari u hoq vetëm në vitin 1918 nga revolucioni, dhe qysh prej vitit 1886, Bavarinë e qeveriste princi-regjent Luitpold, në vend të mbretit Oton, të cilin e kishin shpallur të çmendur. Qyteti, dikur seli dukësh dhe mbretërish, me shkëlqimin dhe luksin e vet feudal mund të mahniste edhe një njeri të shetit, e jo më lybekasin nëntëmbëdhjetëvjeçar, të mësuar vetëm me rreptësinë protestante të vendlindjes së vet veriore. Por, ajo risi që e tërhiqte më tepër djaloshin të Mynihu, nuk ishin godinat dhe rrugët e shumta, por siguria me të cilën këtu arti e radhiste veten ndër veprimtaritë më të natyrshme, të rëndësishme dhe jetike. Ekspozitat sezonale të pikturës, koncertet në Galerinë e Strategëve, dyqanet e antikave, ballot me maska, karnavalet e përhershme në prag të kreshmës, zejtaria artistike popullore, kafenetë, ku poetët kryenin ritet e veta estetike, rrethet letraro-dramatike, ndërrimi ceremonial i rojeve, i cili ngjante me një shfaqje teatrale – të gjitha këto, ndryshe nga Lybeku, krijonin “një atmosferë humanizmi, individualizmi tolerues, një shpengim maskarade, si me thënë, një atmosferë sensualiteti gazmor, artistizmi”. Po, të gjitha këto e mbushnin plot shpresë dhe frymëzim vetëm në fillim, kur ende ky pushtet i artit mbi jetën e përditshme nuk e kishte shfaqur anën e vet të dyshimtë, kur ende djaloshi nuk e kishte ndjerë sipërfaqshmërinë, zbrazëtinë, madje imoralitetin e këtij estetizmi të shfrenuar.

Sidomos në distancë. Se jeta në Mynih nuk filloi me njohjet letrare dhe me pjesëmarrjen në shfaqjet diletante, por me punën në bankën e sigurimit. “Në tavolinën time, midis nëpunësve që plot zell thithnin duhan me hundë, ndërkohë që regjistroja policat e sigurimit, shkruaja fshehtas tregimin tim të parë, novelën “Rënia”, e cila më solli suksesin e parë letrar”. Një prej studiuesve të krijimtarisë së Tomas Manit, Klaus Shreter, konstaton:” Thënia se tregimin e parë Tomas Mani e ka shkruar fshehtas, nën tavolinën me formularët e policave, tingëllon si anekdotë. Prandaj të gjithë biografët e tij nuk e lenë pa e përmendur. Ndërkohë, mbas punës në zyrë, Tomas Mani me siguri i mbetej mjaft kohë e lirë për të punuar për novelën “Rënia” në shtëpi”. Ky konstatim ka shumë mundësi të jetë i drejtë, megjithëse apartamenti ku banonte me nënën, me dy motrat dhe vëllanë trevjeçar, dhe ku mbrëmjeve senatoresha e shoqërueshme priste mysafirë shpesh, nuk ishte vendi më i përshtatshëm për të qëndruar në vetmi. Ky apartament ndodhej në Rambergshtrase, pikërisht në atë rrugë, ku ai do të strehojë si “qiraxhi të vejushës së një senatori nga Bremeni” heroin e “Doktor Faustit”, Adrian Leverkynin. Kurse për Leverkynin do të thotë se “e kishte lodhur dhoma në Rambergshtrase, e cila e detyronte të komunikonte vazhdimisht me familjen e zonjës së shtëpisë dhe nuk i garantonte vetmi të plotë, sepse gjithmonë dikush mund t’ia behte për ta ftuar të bashkohej me mysafirët”. Megjithatë, mbasi mori lëvdatën e parë të autoritetshme për këtë tregim, djaloshi e la bankën e sigurimit.

Në novelën “Rënia”, të cilën Tomas Mani kurrë nuk e përfshiu në përmbledhjen e veprave të veta, sepse e quante “vepër tepër të paarrirë, megjithëse, ndoshta jo pa melodiozitet”, tregohet një histori me subjekt të thjeshtë, madje ordiner. Një student nëntëmbëdhjetëvjeçar dashurohet me një aktore njëzetvjeçare, e cila i përgjigjet pozitivisht ndjenjës së tij të sinqertë. Një mëngjes, kur vjen te e dashura pa e paralajmëruar, djaloshi gjen një plak të panjohur, kurse mbi komodinë pranë krevatit i kap syri disa kartëmonedha. Kjo është, në thelb, gjithë historia që përshkruhet si një tregim brenda tregimit. Por ajo paraqitet në një mënyrë kaq joordinere, me një saktësi kaq të habitshme në përshkrimin e të

gjitha lëvizjeve të shpirtit të djaloshit, në fillim të dashuruar e të lumtur, pastaj të habitur e të tronditur, me një vërtetësi kaq bindëse në përshkrimin e kursyer të jetës së përditshme të një studenti të porsalarguar nga shtëpia prindërore dhe të jetës së përditshme të një aktoreje ordinere të dorës së tretë, saqë revista e Lajpcigut “Di gezelshaft” e botoi menjëherë novelën, kurse poeti i njohur Rihard Demel, i cili gjithashtu punonte në një institut sigurimi, sapo e mbaroi së lexuari i dërgoi Tomas Mani një letër entuziaste dhe i propozoi të botonte në revistën e re letraro-artistike “Pan”.

Vetëm pas suksesit të parë ia lejoi vetes të njoftonte nënën se dëshironte të bëhej gazetar. Ky sukses nuk mund të mos ishte imponues për senatoreshën, për të cilën muzat, gjithashtu, nuk ishin të huaja (përveç këngës dhe lojës në piano, ajo merrej edhe me pikturë). Madje Mynihu e kishte tërhequr si qendër kulturore, dhe vizitorët e saj më të shpeshtë ishin poetë, piktorë, aktorë, me një fjalë njerëz të artit. Kjo menjëherë ra dakord me djalin, edhe për arsye se ky e kishte përgatitur truallin për bisedën vendimtare duke siguruar mbështetjen e njërit prej miqve të nënës, një juristi, të cilit ajo gjithmonë ia dëgjonte këshillat praktike.

Të gjitha këto – botimi i tregimit, marrja e letrës së Demelit, largimi nga banka e sigurimit – ndodhën brenda dy-tri javësh vjeshte. Pa humbur kohë, Tomas Mani u regjistrua në Institutin Politeknik dhe në universitet si student i jashtëm. Ashtu si edhe vëllai, Hajnrihu, i cili jetonte i ndarë nga familja dhe ndodhej në Francë, Tomasi merrte 160-180 marka në muaj për shpenzime vetiake nga përqindjet e kapitalit që kishte lënë babai dhe që i administronte nëna. Filloi të ndiqte leksione të ekonomisë politike, të historisë së kulturës dhe të historisë së përgjithshme, të mitologjisë gjermane, të estetikës, si edhe leksione për tragjeditë e Shekspirit. Kërkesa me listën e këtyre kurseve mban datën 4 nëntor 1894. Kurse më 9 nëntor ai i përgjigjet letrës së Demelit: “Fatkeqësisht, nuk kam asgjë të gatshme për shtyp, por sapo të kem ndonjë gjë të përshtatshme, nuk do të harroj t’Jua dërgoj”.

Dhe i përvishet punës me të gjitha forcat. “Sa e vështirë është,- shkruante Tomas Mani, -të arrish të bësh atë gjë, për të cilën je

krijuar dhe të ngrihesh në lartësinë e qëllimeve, me të cilat të ka lidhur zoti, madje edhe nëse këto qëllime janë tepër modeste.” Këtë e ka thënë në tetralogjinë për Jozefin në lidhje me heroin e saj, të cilit iu desh të punonte shumë në rini që t’i provonte vetes dhe botës se e kishte të bazuar pretendimin e vet për një fat të jashtëzakonshëm, të shkëlqyer. “Por ai,-thuhet më tej,- ishte i ri, shumë i gatshëm e i vendosur të ngrihej në nivelin e qëllimeve të zotit”. Këtë e ka thënë për Jozefin e legjendës biblike, por natyrisht në të njëjtën kohë edhe për vetveten. Në këto fjalë ka më tepër të vërtetë autobiografike, sesa në tonin e faqeve kushtuar rinisë të “Shënime nga jeta ime” që e kemi cituar disa herë dhe do ta citojmë përsëri. Në këtë libër, vitin e parë në Mynih dhe jetën në Itali Tomas Mani i kujton me një buzëqeshje ironike, duke u ndalur jo aq në punën e vet, sa në argëtimet (rrethi i dramës, kafeneja, kardinali i stolisur në katedralen e Shën Pjetrit etj.), sikur nuk i jep rëndësi punës së vet krijuese dhe sikur nuk i kushton seriozitet, gjë që mund të krijojë te lexuesi përshtypjen se novelat e para janë shkruar ashtu, si rastësisht, duke biseduar me miqtë, duke pirë ponç apo duke luajtur domino. Toni i këtyre kujtimeve shpjegohet edhe me faktin se ato janë shkruar në vitin 1930 (autori e shikon veten nga lartësia e pjekurisë), edhe me zakonin e Tomas Manit për përdorimin e ironisë si një mënyrë për ta bërë objektiv narracionin, edhe thjesht me faktin se flet për vetveten.

Më 9 nëntor ai nuk kishte asgjë të gatshme për shtyp, por më 29 nëntor i dërgon Demelit për revistën “Pan” novelën “Profesori i vogël”, duke shpresuar që, megjithëse “këtë herë objekti është shumë më i parëndësishëm sesa te “Rënia”, nga pikëpamja letrare do të mund të konstatohet njëfarë përparimi” në krahasim me tregimin e parë. Duke pasur parasysh se pikërisht në nëntor filloi të ndjekë leksionet në institutin politeknik, mund të thuhet me bindje se largimi nga banka e sigurimit nuk ishte fillimi i “limontisë”, por përkundrazi, ishte fillimi i një pune mendore intensive dhe sistematike. Revista “Pan” nuk e pranoi këtë novelë, por, meqenëse Demeli i dërgoi autorit një përgjigje “jashtëzakonisht të këndshme”, kurse Tomas Mani mbas gjashtë muajsh e njoftoi Demelin për

botimin së shpejti të “Profesorit të vogël” në një revistë tjetër, rezulton se revista e mësipërme nuk e refuzoi për dobësi artistike, por për ndonjë arsye tjetër. Novela “Profesori i vogël” nuk është ruajtur, por bija e shkrimtarit, Erika, mendon se në letërkëmbimin me Demelin bëhet fjalë për tregimin që njihet me titullin “Zotëria i vogël Frideman”. Nëse është kështu, kjo do të thotë se qysh muajin e parë, mbasi u çlirua nga detyrimet e shkollës dhe të punës, Tomas Mani nëntëmbëdhjetëvjeçar shkroi, apo, gjithsesi, përfundoi tregimin, titullin e të cilit e ka marrë përmbledhja e tij e parë që mundi të botohej vetëm në vitin 1898. Mbasi i dërgon Demelit “Profesorin e vogël”, nis punën për një novelë tjetër dhe për një përrallë dramatike në vargje. Vjershat e vogla lirike nuk i quante punë të mirëfilltë. “Sepse për vjershat,-i shkruan nga Mynihu shokut të gjimnazit Grautof,- nuk duhet as zell, as durim. Zakonisht i shkruaj kur më vjen gjumi”.

Kështu, ditët e dimrit të parë në Mynih kalonin pranë tavolinës së shkrimit dhe në auditoret e institutit. Edhe mbrëmjet, që kalonin në teatre, koncerte, në provat e “Shoqatës dramatike akademike” apo në shoqërinë e letrarëve dhe artistëve të rinj, të cilët pas botimit të tregimit të tij të parë e konsideronin shok, madje edhe mbrëmjet e gjata të karnavaleve të shkurtit, që në Mynih ishin mjaft të goditura artistikisht, edhe ato e mbushnin me përshtypje të reja dhe i shërbenin si shkollë e mendimit dhe e shijes, shkollë që iu nënshtrohej interesave të punës së ditës. Lëvdatën e Demelit, si edhe lëvdata të tjera të mëvonshme, i quante, para së gjithash, diçka obliguese. Më pas ai thoshte se “talenti është si një vampir që të pi gjakun”, se ai, Tomas Mani, shumë vite ka jetuar ndryshe nga të rinjtë e tjerë, i përqendruar vetëm në artin e vet, ka bërë thjesht një jetë prej ekzekutuesi, prej përfaqësuesi, rrjedhimisht, të varfër dhe të ftohtë. Konstatojmë se këtë lloj jete e ka filluar qysh vitin e parë në Mynih, fill pas përgjigjes së Demelit. Largimi i ngutshëm nga puna është shprehja e parë e vullnetit të talentit, i cili paskëtaj, në mënyrë gjithnjë e më të rreptë, zotëron kohën, kureshtjen, kontaktet e artistit me njerëzit.

Ndër përshtypjet e këtij viti të mbushur me ndryshime dallohet një përshtypje veçanërisht e thellë. Pikërisht në këtë kohë ka lexuar Niçen dhe ka ushqyer për filozofinë e tij një dashuri të vështirë, kontradiktore, e cila është bërë me të vërtetë “një fakt biografik” i Tomas Manit. Ndikimi shpirtëror nga Niçja, i cili gjeti shprehje në temat dhe stilin e prozës së tij të hershme djaloshare, përcaktoi më vonë në një masë të madhe edhe qëndrimin që shkrimtari mbajti në fillim të luftës së parë botërore.

Duke mbështetur amoralizmin dhe kultin e forcës në vend të moralit të përmbysur, duke u hedhur në sulm kundër arsyes, duke operuar me koncepte të tilla si “mbinjeriu” dhe “bisha leshverdhë”, kjo filosofi, ndonëse e mbushur me protestë kundër moralit të rremë të shoqërisë borgjeze dhe kundër artit të shteruar dekadent që nuk ka kurrfarë idesh të mëdha, të përgjithshme, edhe vetë nuk kishte asnjë ide të mbarë pozitive, edhe vetë ishte një lule e harlisur e dekadencës, një lule e helmët, me të cilën pastaj ideologjia më reaksionare e mikroborgjezisë - ideologjia fashiste, përpiquej të zbukuronte pamjen e vet prej bishe, sepse e tillë është logjika e luftës kundër arsyes. Në të ngrysur të jetës, më 1947, në artikullin “Filosofia e Niçes në dritën e përvojës sonë” Tomas Mani i bën një analizë të hollësishme kësaj filosofie. Në rini, kur “përvoja jonë” (kemi parasysh përvojën historike të shek XX) ende mungonte, dhe kur letrari i ri i provonte forcat vetëm në zhanret e beletristikës, natyrisht, nuk ishte në gjendje që mosbesimin e vet ndaj gjykimeve të Niçes ta shpjegonte kaq qartë dhe me përgjithësi kaq të thella, sa në pleqëri. “Pothuajse asgjë nuk i besoja dhe pikërisht kjo e mbushte plot pasion të dyanshëm dashurinë time për të, e bënte atë të thellë”.

Duke operuar me konceptet: “jetë”, “kulturë”, “ndërgjegje”, “njohje”, “art”, “aristokratizëm”, “moral”, “instinkt” dhe pothuajse duke e identifikuar “kulturën” me “jetën” dhe me “aristokratizmin” e saj, Niçja, “kulturës”, “artit”, “instinktit” iu kundërvinte “njohjen” dhe “moralin” si armike të tyre dhe si parime shkatërruese. Në këtë kundërvënie Niçja arrinte deri në mohimin e tërbuar të kriterëve morale si të tilla, të mirën, të vërtetën, drejtësinë, i shpallte iluzione

ngushëlluese të njerëzimit dhe, duke e quajtur jetën gjithmonë të rreptë, të ashpër, të rreme, ia gjente edhe justifikimin e vetëm, por më të fortin, thoshte se jeta përbën një dukuri estetike.

Çfarë e tërhiqte djaloshin te kjo filosofi? Nuk e tërhiqnin ekstremet e saj, nuk e tërhiqte himnizimi i vullnetit dhe i pushtetit, i forcës, i entuziazmit ekstatik para fytyrës gjakatare të jetës, nuk e tërhiqte mohimi i shpirtit, i arsyes, i njohjes si pengesa në rrugën e “aristokratizmit” dhe të “kulturës”. Jo, nuk e tërhiqnin ekstremet e saj, ndonëse më vonë, kur shpërtheu lufta e parë botërore, Tomas Mani, duke e përshëndetur luftën si konfirmim të kulturës gjermane, e përdorte fjalën “kulturë” në një kuptim mjaft të afërt me kuptimin niçean, dhe në publicistikën e vet polemike të asaj kohe shfaqti ndaj “kompleksit magjik” të filosofisë së Niçes një pasion shumë më të madh nga sa e kishte shfaqur ndonjëherë ndaj saj si artist. “Ç’punë kisha unë me filosofemën e tij të forcës dhe me “bishën leshverdhë”? Ato për mua ishin pothuajse një pengesë”, -shkruante ai rreth njohjes së parë me Niçen. Djaloshin e tërhiqte në radhë të parë vendosmëria e pamëshirshme, e pamëshirshme ndaj vetvetes, me të cilën Niçja merrte guximin të kundërvinte moralin dhe jetën, t’i shpallte ato antagoniste dhe, në kundërshtim me natyrën e tij si njeri i shkencave humanitare, të mos shprehej në favor të moralit. Kjo e tërhiqte para së gjithash, por jo vetëm kjo. Për djaloshin, para syve të të cilit po shembeshin themelet e mënyrës byrgere të jetesës së shëndoshë në dukje dhe të etikës së saj, për djaloshin, i cili, sipas tregimit “Rënia”, tashmë ishte ndeshur me ashpërsinë e jetës në një sferë që në ndërgjegjen e njerëzve të moshës së tij zë një vend veçanërisht të madh, në sferën e seksit, përbënte zbulesë edhe vetë kjo kundërvënie e patundur që iu bëhej moralitetit dhe të drejtës supreme, të pamëshirshme, të parë dhe të fundit të qënies.

Por dashuria e djaloshit për filosofinë e Niçes ishte dashuri pa mirëbesim. Duke thënë më pas se “hymnizimi që ai i kishte bërë “jetës” në dëm të shpirtit, kjo lirikë, e cila kishte pasoja aq të dëmshme në mendimin gjerman, mund të përvetësohej vetëm në një mënyrë: si ironi”, Tomas Mani nuk ndreqte pas të vjelash biografinë e vet “të brendshme”, por paraqiste tablonë reale të kontradiktës së

vet të hershme me Niçen. Për këtë dëshmojnë novelat e para të shkrimtarit të ri, si për shembull, “Zotëria i vogël Frideman” apo “Luiz’heni” ku “jeta“, të cilën e personifikon bukuroshja mizore dhe grabitqare zonja fon Rinlingen, apo joshësja epshore dhe sadiste Amra Jakobi, “jeta”, e cila, shndërrohet në vdekje për ata që janë të dashuruar pas saj, shfaqet në një dritë tepër të dyshimtë. Autori nuk e shikon jetën me shikim të turbulluar nga entuziazmi “dionisian”, siç shprehej Niçja, por e shikon atë me shikim të kthjellët, vlerësues, skeptik. Si dëshmi jo më pak bindëse e përvetësimit ironik të “lirikës” së Niçes mund të shërbejnë edhe vizatimet e Tomas Manit në “Librin me figura për fëmijët e mirë”,- një album për të cilin do të flasim.

Në prill të vitit 1895, Hajnrih Mani u bë redaktor i revistës berlineze “Shekulli i njëzetë”, dhe i propozoi vëllait të vogël të bashkëpunonte me këtë revistë. Tomasi e pranoi propozimin e Hajnrihut. Në vitet 1895-1896 botoi disa artikuj te “Shekulli i njëzetë”. Këta artikuj nuk i ka përfshirë në asnjë përmbledhje të mëpasme, madje bashkëpunimin me revistën “Shekulli i njëzetë”, gjithmonë e kalonte me heshtje në shënimet autobiografike.

Tashmë i kemi përmendur thëniet e tij se për shumë vite ai kujdesej vetëm për famën e vet si artist. Pandashmërinë e famës artistike nga fama shoqërore ai e kuptoi vetëm në moshë të pjekur, falë mësimëve të hidhura të historisë, e kuptoi gradualisht dhe seriozisht vetëm në luftë kundër fashizmit. Kur meditimet për luftën e parë botërore i quajti “Meditime të një apolitiku”, ai subjektivisht ishte me të vërtetë apolitik. Në rini zhvillimi i tij filosofiko-estetik nuk shoqërohej me zhvillimin politik. Ai meditonte rreth Rihard Vagnerit dhe Frederik Niçes, por pak dinte për bashkëkohësit dhe bashkatdhetarët e vet më të vjetër si Frederik Engels, August Bebel dhe Vilhelm Libkneht.

Revista “Shekulli i njëzetë” kishte nëntitullin “Fletore në mbrojtje të mënyrës së jetesës gjermane dhe të lumturisë gjermane”. Po të krahasohen shkrimet publicistike të Tomas Manit në këtë revistë me novelat e tij të para, është vështirë të besohet që ato janë shkruar nga i njëjti person. Artisti origjinal, ironik, i ndjeshëm ndaj

natyrës kontradiktore të karaktereve njerëzore del në tribunën e gazetarit me një mori frazash të përgjithshme të tipit nacionalist dhe shovinist. ”...Gjermanët,-shkruan, për shembull, Tomas Mani njëzetvjeçar në njërin nga këta artikuj,- duke qenë populli i kulturuar më i ri dhe më i shëndoshë i Europës, kanë për mision, si asnjë komb tjetër, të jenë dhe të mbeten mbartës të dashurisë për atdheun, të fesë dhe të besnikërisë ndaj vatrës familiare”.

Duke ndjerë ndryshimin shpirtëror midis publicistikës së hershme dhe krijimtarisë artistike, apo, siç shprehej ai, midis “shkrimtarisë” dhe “muzikimit”, Tomas Mani tridhjetvjeçar do të thotë se “shkrimtaria” i ngjall një ndjenjë torturuese, se më kot e komprometon veten me të dhe se do të bënte mirë të merrej vetëm me “muzikën” e vet. Por në moshën dyzetvjeçare (për këtë do të flasim më vonë) ai, për hir të “shkrimtarisë” do ta lërë përkohësisht mënjanë “muzikën” dhe do ta komprometojë veten duke shtjelluar dhe thelluar te “Meditimet e një apolitiku” pikërisht ato ide nacionaliste që vinin në lëvizje penën e bashkëpunëtorit të ri të “Shekullit të njëzetë”. Ç’tregon kjo? Së pari, një pjekje politike jashtëzakonisht të ngadaltë të një artisti të pjekur shumë herët. Së dyti, paaftësinë e tij organike për t’u mbyllur në “muzikën” e vet. Si nga njëra, ashtu edhe nga tjetra pikëpamje, viti i tij i parë në Mynih paracaktoi rrugën e tij të mëtejshme.